



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit



Auditim i performancës

Prishtinë, mars 2024

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetua dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit, që kryesohet nga Auditori i Përgjithshëm, e ndihmon në kryerjen e detyrave të tij/saj. Së bashku kontribuojnë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000²).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë³, efikasitetit⁴ dhe efektivitetit⁵ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës “Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Ariana Gjonbalaj Shala, Drejtor i Departamentit të Auditimit

Agron Hoxha, Udhëheqës i Ekipit

Elira Hashani, Anëtare e Ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - Adresa: Lagjja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi 210, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +381(0) 38 60 60 04/1011

¹ Ligjin 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

² Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

³ Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

⁴ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁵ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

TABELA E PERMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	1
1 Hyrje	3
2 Objektiva e auditimit dhe pyetjet e auditimit.....	5
3 Gjetjet e auditimit.....	6
3.1 Financimi përmes sponsorizimit përgjatë viteve 2020-2022.....	7
3.1.1 Strategjia për zhvillimin të sportit ende e pa aprovuar.....	8
3.1.2 Përdorimi i sponsorizimit për fushatë marketingu të kompanive private.....	8
3.1.3 Përfituesit e fondeve të sponsorizimit nuk kanë objektiva të qarta për shpenzimin e tyre	9
3.1.4 Shpenzimi i fondeve të sponsorizimit për aktivitete jo sportive	10
3.1.5 Konfliktet e mundshme të interesit në procesin e vlerësimit të sponsorizimit.....	11
3.1.6 Mos raportimi me kohë nga organizatat sportive.....	12
3.1.7 Përfituesit e sponsorizimit nuk i kanë përmbushur kriteret e raportimit	13
3.1.8 Shmangie të tatimit në emër të zbritjeve për sponsorizim të sportit.....	14
3.2 Financimi përmes subvencionimit përgjatë viteve 2020-2022.....	17
3.2.1 Vonesa në caktimin e koeficientit për federata.....	17
3.2.2 Financimi i përfaqësuesve të Federatave sportive është përcjellur me mangësi	18
3.2.3 Financimi i organizatave sportive nuk është i rregulluar qartë	19
3.2.4 Avancet e pa mbyllura të federatave dhe klubeve sportive të cilat kanë përfituar në vitin 2020-2022	20
3.2.5 Financimi i organizatave sportive pa thirrje publike për vitin 2020.....	23
3.2.6 Keq menaxhim i projektit data-baza sportive e Kosovës.....	23
3.2.7 Mungesa e monitorimit të fondeve të subvencionuara dhe sponsorizuara	24
Konkluzionet	26
Rekomandimet	28
Shtojca I Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	30
Motivi i Auditimit.....	30
Kriteret e Auditimit	31
Fushëveprimi i auditimit	32
Metodologjia e auditimit	32
Shtojca II Aneks.....	33
Shtojca III Letër konfirmimi dhe komentet e entitetit.....	40

Lista e shkurtesave

MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
DS	Departamenti i Sportit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
KOK	Komiteti Olimpik i Kosovës
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
SHPK	Shoqëri më Përgjegjësi të Kufizuara
OJQ	Organizata jo qeveritare

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës “Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), përcakton politikat e përgjithshme të zhvillimit të sportit, në përputhje me prioritetet e masovizimit dhe të ngritjes së cilësisë së tyre. Ajo duhet të krijojë kushtet infrastrukturale, financiare dhe kadrovike për përmbushjen e objektivave të caktuara.⁶

Objektivë e këtij auditimi ka qenë të vlerësojmë financimin e sportit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nga bizneset private përgjatë viteve 2020-2022 në mënyrë që të identifikojmë dobësitë, dhe fushat për përmirësim për të garantuar transparencën, llogaridhënien dhe përdorimin e duhur të fondeve.

Subjekt i këtij auditimi kanë qenë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Administrata Tatimore e Kosovës. Fushëveprimi është fokusuar përgjatë viteve 2020-2022.

Rezultatet tona të auditimit tregojnë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka arritur t'i mbajë përgjegjës organizatat të cilat i financon dhe atyre që përfitojnë vërtetim sponsorizimi nga bizneset private. Një pjesë e madhe e organizatave sportive nuk kanë raportuar se si i kanë shpenzuar fondet e subvencionimit dhe kanë përfituar në vazhdimësi. Ndërsa Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka arritur t'i identifikoj dhe të ndër marrë masat ligjore ndaj kompanive të cilat janë liruar nga tatimi për sponsorizim dhe të cilat nuk i kanë dhënë fondet për sponsorizim.

Aktivitetet e subvencionuara dhe sponsorizuara nga kompanitë private nuk i arrijnë qëllimet e tyre dhe nuk realizohen siç duhet. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka arritur të hartojë strategji për zhvillimin e sportit, duke rezultuar në mungesë të drejtimit në zhvillimin e sportit në Kosovë. Praktikant me të cilat vepron Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për subvencionimin dhe lejimin e sponsorizimeve të kompanive private për organizatat sportive nuk ofrojnë qëllime të qarta për shfrytëzimin e fondeve. Për më tepër, ekziston një mungesë e dukshme e dëshmive që vërtetojnë se këto kontribute financiare në mënyrë efektive kanë përmirësuar cilësinë e sportit në Kosovë. Nuk ka dëshmi që sigurojnë se fondet janë shpenzuar, pra nuk ka një sistem që verifikon se aktivitetet janë realizuar në terren ashtu siç ishin planifikuar. Po ashtu Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka një strukturë të përcaktuar për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të sponsorizuara nga kompanitë private dhe si pasojë gjatë periudhës 2020-2022 nuk ka zhvilluar asnjë monitorim. Kjo mungesë e monitorimit ka lënë hapësira për dyshime në lidhje me përdorimin e efektshëm të burimeve publike dhe realizimin e synimeve të interesit publik.

Fondet e sponsorizimit nuk kanë arritur qëllimet për ngritje të cilësisë së sportit në vend. Nga analiza e mostrave të sponsorizimit kemi gjetur se një pjesë e këtyre fondeve përdoret shpesh për qëllime të marketingut të kompanive të sponsorizuara, duke rrezikuar që fondet mos të përdoren për interesin publik. Nga analiza e aplikimeve për vërtetime të sponsorizimit, kemi vërejtur se arsytet e financimit të organizatave sportive nuk ishin të qarta e në disa raste ishte cekur se këto fonde do të përdoren për marketingun e kompanive sponsorizuese.

⁶ Ligji nr. 2003/24 ligji i sportit neni 8

Organizatave sportive gjatë viteve 2020-2022, nuk kanë raportuar për shpenzimet e subvencioneve në vlerë prej 3.5 milionë euro të financuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Organizatat sportive përveç financimit të rregullt me memorandume bazë për subvencionim përfitojnë edhe memorandume shtesë (aneks) për të cilat nuk kemi gjetur se kjo formë e financimit është e rregulluar me akte të brendshme administrative. Në disa raste shuma në aneks e tejkalon atë në memorandum bazë. Kjo mënyrë e financimit tregon për mungesën e transparencës dhe përgjegjshmërisë në raportimin e shpenzimeve të organizatave sportive. Përveç financimeve me memorandume dhe me thirrje, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka financuar organizatat sportive edhe pa thirrje publike, vetëm me kërkesa drejtuar në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, formë të cilën nuk e ka të paraparë në ligje dhe rregullore. Edhe pse organizatat sportive kanë përfituar fonde subvencionimi nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ato nuk kanë raportuar në vlerën prej 3.5 milion euro se si i kanë shpenzuar këto fonde. Përveç kësaj, një nga Organizatat Joqeveritare përfituese e projektit “databaza sportive në Kosovë” nuk ka dorëzuar produktin/raportin final me kohë për të cilin Ministria kishte paguar 121,430 euro. Për më shumë, edhe pas dorëzimit të produktit, Ministria as nuk e ka shqyrtuar e as pranuar të njëjtin përmes komisionit për të vlerësuar apo maksimizuar përfitimin nga ky projekt. Për pasojë, vlera për parane e shpenzuar nuk është materializuar.

Sponsorizimi dhe lirimi i tatimit për kompanitë private ka rezultuar me shmangie tatimore. Nga 45 mostrat e testuara kemi gjetur se mbi 490 mijë euro nuk janë transferuar tek klubet sportive si sponsorizim nga kompanitë private edhe pse në Administratën Tatimore të Kosovës kompanitë kishin raportuar se i kishin dhënë këto mjete për sponsorizim. Për më tepër këto kompani sponsorizuese janë liruar nga tatimi dhe si rrjedhojë nuk i kanë paguar tatim shtetit. Përveç kësaj, klubet sportive kanë përfituar sponsorizim mbi një milion euro nga kompanitë private e për të cilat nuk kanë pasur vërtetim për sponsorizim nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Mungesa e koordinimit ndërmjet Ministrisë së e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Administratës Tatimore të Kosovës ka bërë që mos të ketë kontroll të duhur për shumën e sakta që duhet tatuar dhe liruar nga tatimi.

Gjetjet e auditimit tregojnë se çështjet që kanë të bëjnë me financimin e sportit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nga bizneset private kërkojnë veprime të menjëhershme dhe për këtë janë dhënë 10 rekomandime. Lista e rekomandimeve është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është pajtuar pjesërisht me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet e dhëna. Ndërsa, Administrata Tatimore e Kosovës është pajtuar me gjetjet dhe rekomandimet e raportit si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Sporti në Kosovë ka një traditë të gjatë dhe ka një rol të rëndësishëm në shoqëri. Sporti paraqet një pasqyrë se si vendet tjera e shohin Kosovën. Me anë të sportit ne jo vetëm që mund të kemi një shoqëri të shëndetshme por edhe të kemi një imazh të lartë në botë.

Vendi ynë sa i përket sportit ka treguar suksese të ndryshme si nga përfaqësimi i sportistëve individual si dhe të ekipeve në gara ndërkombëtare, por edhe nga anëtarësimi i federatave përkatëse në organizatat evropiane dhe botërore të sportit.

Në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (tutje MKRS-së) është Departamenti i Sportit (tutje DS), i cili që nga themelimi i tij, ka konsistuar në përgatitjen, vlerësimin dhe aprovimin e politikave programore të sportit, të cilat kanë të bëjnë me masivizimin e sportit dhe zhvillimin kualitativ të tij.

MKRS-ja çdo vit mbështet dhe ndihmon zhvillimin e aktiviteteve sportive, përmes të cilave synon të kontribuoj në organizimin përmbajtësor, zhvillimin e kuadrove, anëtarësimin dhe licencimin e sportit në Kosovë dhe në arenën ndërkombëtare. Gjatë vitit 2022, Ministria ka ndarë mjete për financimin në fushat e përgjithshme dhe të veçanta të sportit. Në fushën e përgjithshme të investimit janë përfshirë: federatat e licencuara të sportit dhe Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ndërsa në fushën e veçantë të investimit janë përfshirë: aneks memorandumet e federatave, memorandumet për aktivitete të veçanta, thirrje publike, kategorizimi i sportistëve, trajnerëve dhe shpresat olimpike, shpërblimet, mbështetje financiare ad hoc, dhe mbështetje financiare të përhershme.

Si formë tjetër e financimit të sportit është edhe ajo përmes bizneseve private ku atyre ju mundësohet zbritje deri në 30% të tatimit në fitim me qëllim që ato mjete të përdoren për financimin e organizatave sportive.

Grafiku 1: shumat e subvencionimit nga ana e MKRS-se dhe bizneset nëpërmjet formës së sponsorizimit⁷.

Burimi: ATK dhe MKRS.

Nga grafika lartë shihet se nga viti 2020 deri në vitin 2022 ka pasur një trend të rritjes së shumës së financimit nga bizneset nga mbi 2 milion euro në vitin 2020 në 9.5 milion euro në vitin 2022. Njëkohësisht, edhe financimi nga ana e MKRS-së përgjatë viteve shihet se ka pasur një trend të rritjes së mbështetjes së sportit në vend.⁸

⁷ Sponsorizimi - mbështetje financiare dhe materiale në bazë të vullnetit të lirë që jepet nga personat fizik apo juridik të vendit dhe të huaj me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Sponsorizimi mundëson sponsorizuesve të promovojnë emrat, bizneset, logot dhe produktet e tyre me qëllim të shfrytëzimit të zbritjeve të lejuara për sponsorizim dhe lehtësirat administrative dhe tatimore (Ligji nr. 05/L-090).

⁸ Raporte të subvencionimit dhe vërtetimet e lëshuara nga MKRS.

2 Objektiva e auditimit dhe pyetjet e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është të vlerësojmë mënyrën e financimit të sportit nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe nga bizneset private përgjatë viteve 2020-2022 në mënyrë që të identifikojmë dobësitë, dhe fushat për përmirësim për të garantuar transparencën, llogaridhënien dhe përdorimin e duhur të fondeve në sport.

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektives së auditimit janë parashtruar pyetjet si në vijim:

1. *A ka arritur Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit të mbështes organizatat sportive në mënyrë të duhur dhe të siguroj që ato plotësojnë kriteret e financimit?*
2. *A kanë arritur Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Administrata Tatimore e Kosovës të sigurohen se aktivitetet e sponsorizuara dhe subvencionuara janë zbatuar?*

Pjesë e fushëveprimit të këtij auditimi ka qenë MKRS-ja dhe Administrata Tatimore e Kosovës (tutje ATK). Në kuadër të Ministrisë ka qenë Departamenti i Sportit dhe Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Nga ATK-ja janë shfrytëzuar të dhënat lidhur me lirimimin nga tatimi i bizneseve të cilat japin sponsorizime për sport. Fushëveprimi është fokusuar përgjatë viteve 2020-2022.

3 Gjetjet e auditimit

Për kryerjen e punëve me interes publik e shtetëror⁹, për edukimin fizik e të sportit, MKRS-ja në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës (tutje KOK), me Federatat Sportive dhe institucionet tjera kompetente harton Strategjinë për zhvillimin e sportit dhe planin e veprimit dhe i propozon Qeverisë miratimin e saj.

MKRS duhet të zhvilloj strategjinë për zhvillimin e sportit dhe planin e veprimit për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të organeve qendrore dhe lokale të Komitetit Olimpik të Kosovës KOK-ut, të Komitetit Paraolimpik të Kosovës, të Federatës sportive të të shurdhërve, të Federatave sportive të Kosovës dhe shoqatave sportive.

Sipas ligjit për sponsorizim të sportit përcaktohet se interesi i përgjithshëm publik është mbështetja e aktiviteteve të ndryshme në promovimin e kulturës, rinisë dhe sportit në nivel vendor dhe ndërkombëtar.¹⁰

Në mënyrë që një organizatë sportive të përfitoj fonde nga kompanitë private për zhvillimin e aktiviteteve sportive duhet të aplikoj për vërtetim në MKRS. Ky vërtetim përmban kriteret dhe kushtet e përfitimit siç janë:

- Përshkrimi i qëllimit të sponsorizimit dhe arsytet se pse përbën interes publik dhe
- Përshkrimin e aktiviteteve që do të mbulohen me mjetet e sponsorizimit.


Po ashtu duhet të plotësohen edhe disa kushte ku klubi duhet të jetë pjesë e federatës dhe të ketë aktivitete sportive në periudhe më të gjatë se 1 vit.

⁹ ligji nr. 04/1-075 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/24 për sport

¹⁰ ligji nr. 05/1 -090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Procesi i sponsorizimit zhvillohet në disa hapa, të cilat i kemi paraqitur në diagramin e mëposhtëm.

Diagrami 1. Hapat e procesit të sponsorizimit për aktivitete sportive nga MKRS-ATK



Më poshtë janë paraqitur gjetjet që kanë të bëjnë me financimin përmes sponsorizimit dhe subvencionimit. Këto gjetje janë rezultat i analizimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, auditimit të proceseve, testimeve si dhe intervistave me zyrtarë përgjegjës në terren. Dëshmitë e auditimit kanë shërbyer në dhënien e konkluzioneve të cilat janë paraqitur në Kapitullin 4 dhe rekomandimeve për përmirësimin e proceseve të cilat janë paraqitur në Kapitullin 5.

3.1 Financimi përmes sponsorizimit përgjatë viteve 2020-2022

Kuvendi i Kosovës në vitin 2017 ka miratuar ligjin për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Me këtë ligj, qeveria kishte qëllim sponsorizimin, realizimin, përkrahjen, promovimin dhe mbështetjen e veprimtarive dhe aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Nëpërmjet këtij

ligji do të realizohej interesi i përgjithshëm publik siç është mbështetja e aktiviteteve të ndryshme në promovimin e kulturës, rinisë dhe sportit në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Sipas këtij ligji, bizneset në vend mund të financojnë aktivitetet sportive deri në masën 30% të tatimit në fitim dhe të përfitojnë zbritje nga pagesa e kësaj shume që duhet të jetë tatim në ATK.

3.1.1 Strategjia për zhvillimin të sportit ende e pa aprovuar

Për kryerjen e punëve me interes publik e shtetëror¹¹, për edukimin fizik e të sportit, MKRS-ja në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës (tutje KOK), me Federatat Sportive dhe institucionet tjera kompetente harton Strategjinë për zhvillimin e sportit dhe planin e veprimit dhe i propozon Qeverisë miratimin e saj.

MKRS nga viti 2015 kishte tentuar katër herë të zhvillojë strategjinë për sport mirëpo që ky proces kishte dështuar çdo herë. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së vullnetit institucional dhe neglizhencës nga ana e MKRS-së. Si pasojë, të gjitha aktivitetet të cilat i financon i zhvillon pa ndonjë strategji apo program se në cilin drejtim do të zhvillohet sporti në vend. Kjo mungesë e strategjisë ka ndikuar në MKRS, duke çuar në një pasiguri në adresimin e nevojave të edukimit fizik, përcaktimin e prioriteteve zhvillimore dhe krijimin e kualifikimeve profesionale.

Megjithatë, MKRS për fushën e sportit në vend ishte mbështetur dhe ka punuar kryesisht me: planet strategjike dhe Operacionale të Qeverisë së Kosovës 2021-2025, Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim, dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimit 2021.

MKRS ka krijuar grupin punues të cilët kanë finalizuar draft strategjinë 2023-2030. Drafti i strategjisë është prezantuar pranë komunitetit sportiv në Tryezën e Tretë të sportit, të mbajtur me 13.06.2023 e cila shërben si platformë konsultative dhe koordinuese për prioritetet e politikave sportive për vitin përkatës. Drafti i strategjisë ka qenë i gatshëm për procesin e konsultimeve publike. Me rastin e shpalljes së Kosovës shtet nikoqir të Lojërave Mesdhetare 2030, grupi punues aktualisht është duke reflektuar në draftin e strategjisë - planin e veprimit për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030.

Mungesa e një programi dhe strategjisë për të udhëzuar se si do të arrihet interesi publik rrezikon që sponsorizimet e aprovuara të mos ndjekin interesat shtetëror apo qëllimet e përbashkëta të sportit. Njëkohësisht, mos-përditësimi i një plani katër-vjeçar për zhvillimin e sportit krijon barriera në modernizimin dhe nevojat aktuale të sportit në Kosovë. Për më shumë, zbehë besueshmërinë ndaj institucioneve publike se fondet publike të dedikuara për zhvillimin e sportit përdoren në mënyrë transparente, të përgjegjshme dhe për qëllimin të cilin janë dhënë.

3.1.2 Përdorimi i sponsorizimit për fushatë marketingu të kompanive private

Ligji për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përkufizon se sponsorizimi i mundëson sponsorëve të promovojnë emrat, bizneset, logot dhe produktet e tyre me qëllim të shfrytëzimit të zbritjeve të lejuara për sponsorizim.

¹¹ ligji nr. 04/1-075 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/24 për sport

*Qëllimi i sponsorizimit është realizimi, përkrahja, promovimi dhe mbështetja e veprimtarive dhe aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.*¹².

Gjatë analizimit të mostrave kemi vërejtur se të gjitha marrëveshjet mes organizatave sportive dhe sponsorëve përfshijnë së paku një formë të marketingut si obligative për t'u zbatuar nga ana e përfituesit të fondeve (klubit sportiv).

Ne kemi hasur në raste ku disa sponsorizime janë bërë me qëllim ekskluziv të marketingut për sponsorët – gjë që dëshmon se një pjesë e këtyre fondeve nuk po shpenzohen për aktivitete sportive por për interes të kompanive sponsorizuese. Në një nga mostrat, një klub sportiv ka pranuar 10 mijë euro sponsorizim me qëllim të reklamimit dhe sportit (siç kanë cekur edhe në aplikacion), ndërsa nuk kishte dorëzuar raport narrativ për të treguar se sa nga ato fonde janë përdorur për reklamimin e kompanisë sponsorizuese. Në një mostër tjetër, një organizatë sportive siguroi sponsorizim prej 350 mijë euro. Gjatë fazës së raportimit, kjo organizatë ka dokumentuar një shpenzim mbi 50 mijë euro për pajisje reklamuese për shfaqjen e reklamave sponsorizuese. Vlen të përmendet se kjo blerje, megjithëse e cilësuar si shpenzim, nuk bën pjesë në kategorinë e aktiviteteve sportive. Pavarësisht dispozitës ligjore që lejon promovimin përmes emrave, logove të biznesit dhe produktet e tyre, ligji ndalon shprehimisht përdorimin e fondeve të sponsorizimit për aktivitete që nuk lidhen me sportin.

Komisioni i përcaktuar në MKRS për dhënien e vërtetimeve për sponsorizim ka njoftuar se në rregullore¹³ nuk është e specifikuar saktë që është e ndaluar promovimi dhe se kishin qenë të kujdesshëm që gjatë procesit të mbylljes, shpenzimet të arsyetohen për materiale të cilat përcjellin mesazhe pozitive në sport, siç janë lufta kundër abuzimit të fëmijëve, fushata kundër kancerit të gjirit, kundër diskriminimit etj.¹⁴ Ndërsa edhe pse i mundëson sponsorit promovimin e tyre përmes emrit, biznesit, logot dhe produktet e tyre, kjo nuk do të thotë se fondet të cilat jepen për aktivitete sportive të përdoren për interes të kompanisë sponsorizuese.

Shfrytëzimi i fondeve për promovimin e kompanisë sponsorizuese, në vend të përdorimit për ngritjen e cilësisë së sportit, rrezikon arritjen e interesit të përgjithshëm publik. Për më tepër, praktika të ndryshme marketingu, duke përfshirë përdorimin e pajisjeve elektrike të reklamimit, tregojnë se fondet publike po financojnë marketingun e kompanive private. Ndërsa Ligji i sponsorizimit u lejon kompanive private të përfitojnë lehtësime në tatim duke mbështetur aktivitete sportive që i përkasin interesit publik.

3.1.3 Përfituesit e fondeve të sponsorizimit nuk kanë objektiva të qarta për shpenzimin e tyre

Në raportin e përmbledhur duhet të përshkruhen të gjitha rezultatet e arritura sipas marrëveshjes përkatëse për sponsorizim, duke i përshkruar afatet kalendarike kur janë realizuar aktivitetet përkatëse, shumat financiare që janë shpenzuar për ato aktivitete dhe numrin e përfituesve nga aktivitetet e realizuara. Raportet

¹² Ligji nr. 05/1 -090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

¹³ Rregullore (MKRS) Nr. 01/2018 për Përcaktimin e Kriteve, Procedurave dhe Formës për Vërtetimin e Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

¹⁴ Pyetjet për Sponsorizim – përgjigje nga komisioni.

e dërguara nga përfituesi i sponsorizimit do të vlerësohen nga komisioni përkatës në kuadër të MKRS-së, i cili e ka lëshuar vërtetimin përkatës për sponsorizim.¹⁵

Nga 119 mostra të sponsorizimit të analizuara, kemi vërejtur se qëllimet për të cilat organizatat sportive kanë përfituar nga sponsorizimi nuk janë paraqitur qartë. Në 55 mostra nuk kanë paraqitur fare rezultatet e arritura gjatë shfrytëzimit të mjeteve të përfituara përmes sponsorizimit.

Në një rast ku kemi shqyrtuar rezultatet e raportuara, kemi vërejtur se klubi gjatë fazës së aplikimit kishte përcaktuar se përdorimin e fondeve do ta shpenzonte për shumë aktivitete në mënyrë që të marr pjesë në gara kombëtare dhe ndërkombëtare. Megjithatë, nga vlera totale 30,000 euro klubi kishte shpenzuar 20,000 euro faturë gjërmim dheu për rregullimin e fushës sportive. Aplikimi dhe rezultatet e raportuara kanë mospërputhje dhe devijon nga fokusi i aktiviteteve të paraqitura sportive gjatë fazës së aplikimit për sponsorizim.

Sipas MKRS-së klubi në fjalë ka pasur mungesa të gjërave elementare siç është fusha e sportit për zhvillimin e aktiviteteve sportive për fëmijë dhe në mënyrë që ti mundësojmë zhvillimin e aktiviteteve sportive i është lejuar gjërmimi i dheut për rregullim të fushës së sportit.

Pra orientimi i shpenzimit të vlerës më të lartë në një aktivitet tregon se ka një planifikim të dobët nga ana e klubeve pa konsultim me MKRS.

Shpenzimi më i lartë i fondeve publike nga pjesëmarrja në gara kombëtare dhe ndërkombëtare në një aktivitet ndikon që të mos arrihet qëllimi me të cilën ka aplikuar klubi në fillim, duke ndikuar edhe në besueshmërinë e klubit për të përfituar sërish financim në të ardhmen.

3.1.4 Shpenzimi i fondeve të sponsorizimit për aktivitete jo sportive

Përmes sponsorizimit të aktiviteteve të ndryshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit realizohet interesi i përgjithshëm i cili sjellë përmirësimin e jetës individuale dhe shoqërore të qytetarëve, organizatave biznesore, fondacioneve, personave fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës. Qëllimi i sponsorizimit është realizimi, përkrahja, promovimi dhe mbështetja e veprimtarive dhe aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.¹⁶

Analizimi i mostrave ka nxjerrë në pah praktika të sponsorizimit që kapin sfera të ndryshme përtej asaj të promovimit. Në dy raste të analizuara, kompanitë sponsorizuese në kontratë me përfituesin e sponsorizimit kanë kërkuar kompensime të cilat nuk konsiderohen interes publik siç janë bileta të udhëtimit, vip bileta për stafin e kompanisë sponsorizuese, etj.

Një rast konkret është marrëveshja me vlerë prej 350 mijë eurove, e cila është planifikuar të ndahet për një periudhë prej tre vitesh. Në këtë marrëveshje, organizata sportive është e obliguar të plotësojë disa kushte të veçanta si në vijim:

- Ofrimi i biletave për çdo ndeshje vendore të Super Ligës të cilat kanë qenë bileta VIP dhe po ashtu 50 bileta të kategorisë së parë;

¹⁵ Rregullore (mkrs) nr. 01/2018 për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe Formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe Sportit neni 12

¹⁶ Rregullore (mkrs) nr. 01/2018 për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe Formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe Sportit neni 3

- Ofrimi i biletave për secilën ndeshje në Ligën e Kombeve dhe për kualifikuesit e Kampionatit Evropian të luajtura në Kosovë gjegjësisht 5 bileta VIP dhe 20 bileta të kategorisë së parë;
- Ofrimi i biletave dhe udhëtimit për secilën prej ndeshjeve të Ligës së Kombeve dhe ndeshjeve kualifikuese të Kampionatit Evropian të luajtur jashtë vendit, minimum 4 bileta VIP.

Në vitin 2020, vetëm për bileta të ndeshjeve vendore, federata sportive ka shpenzuar një shumë prej 12,500 eurove për kompaninë sponsorizuese.

Në një rast tjetër, kompania sponsorizuese ka vendosur në kontratë me sponsorizuesin (klubin sportiv) të emërojë një person nga stafi i tyre si anëtar të bordit të organizatës sportive. Ky aspekt i marrëveshjes tregon se sponsorët kërkojnë jo vetëm promovim të kompanive të tyre, por edhe një nivel të caktuar të kontrollit dhe ndikimit në proceset vendimmarrëse të organizatës sportive.

Në dy raste, kemi vërejtur se pronarët e klubeve janë edhe si pronarë të bizneseve që sponsorizojnë klubet e tyre përkatëse. Për më tepër, megjithëse klubet sportive kanë raportuar shpenzimet e fondeve të sponsorizimit tek MKRS, mungesa e qartësisë rreth transferimit të fondeve nga llogaria bankare e klubit sportiv në llogarinë bankare të biznesit apo personale të pronarit krijon dyshime në lidhje me trajtimin e këtyre fondeve. Kjo mënyrë e menaxhimit të fondeve, që buron nga donacionet ose sponsorisime, mund të hedhë dyshime mbi praktikën financiare të organizatës.

Nga forma e financimit të organizatave sportive shihet se financimi i sportit përmes sponsorizimit paraqet një formë jo të sigurt të aplikimit dhe përfitimit të këtyre fondeve nga organizata sportive. Kërkesa e sponsove që klubi të organizojë marketingun e kompanisë sponsorizuese, kërkesa për bileta për ndeshje për stafin e kompanisë sponsorizuese, bileta udhëtimi dhe akomodimi tregojnë se këto fonde të sponsorizimit (apo tatime të cilat do të duhej derdhur në buxhetin e shtetit) përdoren për qëllim dhe në interes të sponsorizueseve dhe jo për zhvillimin e sportit në vendin tonë. Po ashtu, mungesa e qartësisë në transferimin e fondeve nga llogaria bankare e klubit sportive në llogarinë bankare të biznesit apo personale të pronarit, tregon për paqartësitë nëse këto transferime janë rimbursime legjitime ose nëse ato përfaqësojnë shpërdorim të fondeve të sponsorizimit për përdorim personal.

3.1.5 Konfliktet e mundshme të interesit në procesin e vlerësimit të sponsorizimit

Raportet e dërguara nga përfituesi i sponsorizimit do të vlerësohen nga Komisioni përkatës në kuadër të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i cili e ka lëshuar vërtetimin përkatës për sponsorizim.¹⁷

MKRS ka të themeluar komisionin përkatës i cili është përgjegjës për të gjithë ciklin nga aplikimi deri tek vlerësimi i raporteve të shpenzimeve të fondeve të sponsorizimit. Nga analiza e vendimeve të MKRS-së shihet se komisioni i njëjtë bënë pranimin e aplikacioneve për lëshim të vërtetimeve të sponsorizimit dhe po ashtu i njëjti është përgjegjës për raportimin e shpenzimit të këtyre fondeve nga organizatat sportive.

¹⁷ Rregullore (mkrs) nr. 01/2018 për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Praktika që është duke e aplikuar MKRS ngre shqetësime për konflikte të mundshme interesi brenda komisionit përgjegjës për lëshimin e vërtetimeve të sponsorizimit dhe vlerësimin e shpenzimeve të fondeve. Kur një komision i vetëm ngarkohet me të dyja funksionet, ekziston një rrezik i natyrshëm që procesit të vlerësimit t'i mungojë paanshmëria dhe integriteti i nevojshëm. Ky konflikt i mundshëm mund të rrezikojë besueshmërinë e procesit të vlerësimit dhe integritetin e rezultateve të raportuara.

Për të adresuar këtë shqetësim, disa vende ose organizata miratojnë praktika që përfshijnë komisionet e veçanta për këto dy funksione thelbësore. Kjo ndarje shërben për të rritur përgjegjshmërinë, transparencën dhe besueshmërinë e përgjithshme të procesit të vlerësimit të sponsorizimit.

Përkundër, që Rregullorja e MKRS-së përcakton se i njëjti komision do të trajtojë lëshimin e vërtetimeve të sponsorizimit dhe vlerësimet e shpenzimeve të fondeve, megjithatë miratimi i një qasjeje apo praktike më të mirë që përfshin ndarjen e këtyre detyrave mund të ndihmojë në zbutjen e konflikteve të mundshme të interesit dhe të përforcojë besueshmërinë e procesit të vlerësimit. Ndarja e detyrave të punës përputhet me standardet ndërkombëtare dhe promovon transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e sponsorizimit.

3.1.6 Mos raportimi me kohë nga organizatat sportive

Përfituesi i sponsorizimit obligohet që të hartojë raport me shkrim lidhur me sponsorizimin e realizuar, dhe atë ta dërgojë në Ministri brenda afatit prej tre muajve. Në rastet kur sponsorizimi është afatgjatë, raportimi bëhet në baza vjetore.¹⁸

Gjatë viteve 2020-2022, kemi një trend të rritjes të mos raportimit të organizatave sportive me kalimin e viteve, po ashtu ka edhe rritje të shumave të cilat organizatat sportive nuk raportojnë. Kjo mund të shihet edhe në tabelën 1.

Tabela 1: Paraqitja e organizatave të cilat kanë raportuar dhe të cilat nuk kanë raportuar për fondet e sponsorizimit 2020-2022.

Viti	Të pa raportuar	Shuma për vit	Të raportuara	Shuma
2020	38	550,145.00	189	3,084,761.00
2021	113	1,613,650.65	575	8,305,782.65
2022	567	8,447,328.60	230	2,528,596.92

Të dhënat e paraqitura me lartë pasqyrojnë gjendjen e raportimit të organizatave sportive deri në korrik të vitit 2023.

Pas përfundimit të auditimit, ne kemi marrë shënime të mëvonshme nga MKRS që tregojnë se figurojnë avanset e pambyllura mbi 936 mijë euro të cilat kishin afat për mbyllje përgjatë vitit 2023. Është e rëndësishme të sqarojmë se procesi ynë i rishikimit ka përfunduar me përfundimin e auditimit andaj, çdo informacion i marrë ose zhvillimet që ndodhin pas kësaj periudhe nuk i janë nënshtruar vlerësimit apo testimit tonë.

¹⁸ Rregullore (mkrs) nr. 01/2018 për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Grafiku 2: Raportimet pas sponsorizimit, 2020-2022.



Nga analiza e mostrave të sponsorizimit të realizuara gjatë viteve 2020-2022, kemi vërejtur se 64% e përfituesve të sponsorizimit kanë raportuar pas sponsorizimit. Ndërsa, 36% të përfituesve nuk kanë raportuar për mënyrën e shpenzimit të fondeve të sponsorizimit.

Përveç mungesës së raportimit, edhe 30% të përfituesve të sponsorizimit nga mostrat e analizuara kanë vonesa në raportim. Në disa raste, ka organizata sportive që kanë raportuar deri në dy vite vonesë për sponsorizimet e përfituara.

Shkak për këto vonesa të raportimit nga organizatat sportive janë mos ndëshkimi i këtyre të fundit dhe mungesa e kontrolleve nga ana e MKRS. Mungesa e

raportimeve në MKRS lidhur me sponsorizimet e përfituara ka ndikuar që MKRS nuk ka informata se si po shpenzohen fondet publike dhe për cilat aktivitete po përdoren ato.

Komisioni i MKRS-së përgjegjës për dhënien e vërtetimeve të sponsorizimit janë në dijeni për këto vonesa, mirëpo sipas tyre as një kërkesë e re për vërtetim të sponsorizimit nuk i shqyrtohet klubeve të cilat kanë sponsorizime të pa raportuara dhe sipas tyre nuk kanë përdorur ndonjë mekanizëm që ndëshkon vonesat në raportim. Mos raportimi me kohë apo mos raportimi i sponsorizimeve rrezikon që klubet t'i shpenzojnë fondet e tyre për të tjera qëllime dhe jo për interesin e përgjithshëm publik.

Po ashtu, gjatë plotësimit të aplikacionit të organizatave sportive për përfitim të sponsorizimit kemi vërejtur se në të gjitha mostrat, kërkohet të bëhet një përshkrim i qëllimit të sponsorizimit dhe përshkrim të aktiviteteve të organizatës. Analizat tona tregojnë se këto aplikacione plotësohen me përshkrime të përgjithshme, si për shembull: "Sponsorizim gjeneral.", "Për qëllime reklamuese.", "Të gjitha aktivitetet e [Organizatës Sportive]". Pra nuk kemi një përshkrim të qëllimit të përfitimit të fondeve të sponsorizimit dhe aktiviteteve të cilat do të realizoj klubi pas përfitimit të sponsorizimit.

3.1.7 Përfituesit e sponsorizimit nuk i kanë përmbushur kriteret e raportimit

Të gjithë përfituesit e sponsorizimit me vlerë 10 mijë euro e më shumë janë të obliguar që të sjellin raportin e auditimit për vitin paraprak në MKRS.

Në rast se një përfitues i sponsorizimit nuk e përmbush detyrën e tij për raportim vjetor lidhur me sponsorizimin e realizuar, nuk do t'i mundësohet trajtimi i lëndëve tjera, si dhe do të sanksionohet.

Analizat tona tregojnë se organizatat sportive gjatë raportimeve të tyre për mbyllje të projekteve të sponsorizuara në MKRS, kanë raportuar me mangësi për disa kritere të kërkuara të cilat janë shpalosur në vijim.

Në katër raste kemi gjetur se raportet e auditimit janë përgatitur nga auditorët të cilët nuk kanë qenë të licencuar për kryerje të këtyre auditimeve.

Në një rast kemi gjetur se nuk është dorëzuar raporti i auditimit për vitin për të cilin organizata kishte përfituar fondet.

Edhe pse zyrtaret e MKRS-së janë arsyetuar se nuk kanë qenë në dijeni lidhur me procesin e licencimit të auditorëve, MKRS duhet të siguroj kontrolle mbi raportet financiare të dorëzuara nga përfituesit.

Pranimi i raporteve nga auditorët e pa licencuar e rrit rrezikun që raportet të mos paraqesin gjendjen reale dhe me saktësi dhe rrezikon që fondet e sponsorizimit të mos raportohen ashtu siç kërkohet.

Po ashtu, në vijim kemi paraqitur një rast që përfituesit nuk kanë raportuar siç duhet lidhur me sponsorizimin e realizuar.

Kemi vërejtur se pronari i klubit sportiv kishte përfituar vërtetim me vlerë 60 mijë euro me qëllim që këto fonde ti shpenzoj për funksionimin e klubit të tij. Pas përfitimit të fondeve të sponsorizimit ky klub sportiv kishte transferuar në llogari të pronarit të klubit shumën prej 40 mijë euro në emër të kthimit të huazimit për pajisje sportive dhe shpenzime operative. Por, nga raportimi i klubit të cilin e kishte dorëzuar në MKRS nuk kemi gjetur dëshmi të cilat tregojnë se shumën e huazuar ishte shpenzuar realisht për aktivitete sportive. Pra nga dosja shihet se klubi ka raportuar me rregull vetëm për shumën prej 20 mijë euro ndërsa shumën prej 40 mijë euro e cila është kthyer si borxh pronarit të klubit, nuk ishte dashur të pranohet nga MKRS si shpenzim për aktivitete sportive. Kjo për shkak se këto sponsorizime duhet të jepen për aktivitete të cilat do të ndodhin në të ardhmen dhe të cilat do të mund të mbulohen me dëshmi të besueshme.

Praktika e tillë e mbulimit të investimeve të viteve të kaluara me fondet e sponsorizimit të cilat jepen për aktivitete të ardhshme tregon se fondet e sponsorizuara lehtësisht mund të keqpërdoren në emër të disa aktiviteteve të kaluara. Po ashtu, mungesa e dëshmive për shpenzimin e fondeve të përfituara nuk siguron se ato aktivitete kanë ndodhur me të vërtetë.

3.1.8 Shmangie të tatimit në emër të zbritjeve për sponsorizim të sportit

Marrëveshja për sponsorizim dhe reklamim me raportin financiar detyrimisht dorëzohet në ATK më së largu tridhjetë ditë nga dita e përmbushjes-përfundimit të marrëveshjes. Vërtetimin për përcaktimin e interesit publik për qëllim të realizimit të të drejtave të palëve për sponsorizim, dhe i cili do të procedohet në ATK¹⁹ nga palët përfituese prej sponsorizimit, duhet të përmban këto të dhëna: emri dhe titulli i dhënësit dhe i pranuesit, emri dhe titulli i shfrytëzuesit të fundit, përshkrimi i lëndës dhe qëllimit të sponsorizimit i cili mundëson identifikimin e tyre me të dhëna të sakta për sasinë, vlerën dhe vetitë tjera të tij, përdorimi përfundimtar i lëndës së sponsorizimit.

ATK-ja dhe MKRS mbikëqyrin dhënien, pranimin dhe shfrytëzimin e sponsorizimit dhe reklamimit për zbritjet e lejuara. ATK-ja dhe organet tjera kompetente, në qoftë se gjatë kontrollit vërtetojnë parregullsi dhe

¹⁹ Rregullore (MKRS) nr. 01/2018 për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (neni 12).

keqpërdorime gjatë shfrytëzimit të sponsorizimit mund të parashtrojnë kallëzime penale apo kundërvajtës sipas legjislacionit në fuqi.²⁰

Nga analiza dhe krahasimet që kemi bërë lidhur me vërtetimet e sponsorizimit kemi vërejtur se lista e vërtetimeve të sponsorizimit të lëshuara nga MKRS për vitet 2020-2022 dhe lista e zbritjeve të tatimit në ATK po për të njëjtat vite, ka një mospërputhje të madhe.

Sipas këtyre listave, kompanitë kanë paguar shuma më të vogla të tatimit se sa kanë qenë të obliguara. Për të verifikuar këtë problem, kemi përzgjedhur mostra nga ATK për bizneset të cilat janë liruar nga tatimi në fitim si pasojë e financimit të sportit. Pastaj kemi krahasuar secilën kompani e cila ka poseduar vërtetim për sponsorizim të klubeve sportive nga MKRS, me secilën kompani e cila ka deklaruar zbritje në ATK. Këto lista kanë qenë për vitet 2020-2022 si kompenzim i sponsorizimit të deklaruar. Rezultatet e krahasimit i kemi paraqitur në tabelën 2.

Tabela 2: Mbi-deklarimet e kompanive private në ATK.

	2020	2021	2022	Mbi-deklarim total
Mbi-deklarim me vërtetim	155,873 €	762,643 €	1,031,600 €	1,950,116 €
Deklarim pa vërtetim	753,751 €	1,151,000 €	1,714,828 €	3,619,579 €
Mbi-deklarim total	909,624 €	1,913,643 €	2,746,428 €	

Nëse e analizojmë tabelën 2 shihet se kompanitë kanë paguar më pak tatime me arsyetimin se ato fonde po i japin për sponsorizimin e aktiviteteve sportive e që në realitet nuk e kanë bërë. Në tabelën e paraqitur lartë kemi paraqitur dy forma të deklarimeve të cilat i kemi shpjeguar me poshtë:

- Mbi-deklarim me vërtetim: në këtë rast kompanitë kanë poseduar vërtetime për një pjesë me të vogël të fondeve të cilat i kanë dhënë për sponsorizimin e sportit ndërsa nuk kanë poseduar vërtetim për shumat e cekura ne tabele siç janë mbi 155 mijë për vitin 2020, mbi 762 mijë për vitin 2021 dhe mbi 1 milion për vitin 2022.
- Deklarim pa vërtetim: në këtë rast kompanitë nuk kanë poseduar vërtetime nga MKRS për fondet e paraqitura me lartë të cilat i kanë dhënë për sponsorizimin e sportit, megjithatë kanë deklaruar për zbritje në ATK.

Duke marrë në konsideratë këtë fakt ne kemi ardhur në përfundim se për tre vite rreth 3.6 milion euro janë dallim ndërmjet listave të vërtetimeve nga MKRS dhe zbritjeve të tatimit në ATK. Kjo mospërputhje ka ndodhur për tre arsyeje siç janë rastet kur kompanitë kanë transferuar mjetet tek klubet pa u pajisur me vërtetim nga MKRS, kompanitë janë liruar nga tatimi pa vërtetim dhe pa i transferuar mjetet tek klubet sportive dhe gabime në databazën e MKRS lidhur me regjistrimin e sponsoreve.

Nga krahasimi i listave të vërtetimeve të sponsorizimit nga MKRS dhe zbritjeve të tatimit të cilat e kanë bërë kompanitë si rezultat i sponsorizimit kemi identifikuar se janë rreth 352 biznese të cilat

²⁰ LIGJI Nr. 05/L -090 Për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (neni 15).

kanë diferenca ndërmjet shumës së sponsorizimit të vërtetimit nga MKRS dhe zbritjeve të tatimit në ATK.

Kemi kërkuar nga ATK që të na ofrojë gjendjen reale se si qëndrojnë këto kompani. ATK ka arritur të siguroj informata për 45 biznese, ku gjendja e tyre është paraqitur me poshtë.

Tabela 3: Gjendja në biznese pas inspektimit nga ATK.

Viti	Nr. i klubeve përfituese të sponsorizimit nga 45 bizneset	Pa vërtetimit	Me vërtetimit	Kanë transferuar fondet në organizatë sportive	Nuk kanë transferuar fondet në organizatë sportive	Kanë dorëzuar informatat në ATK sipas ligjit	Nuk kanë dorëzuar informatat në ATK
2020	26	8	18	25	1	14	12
2021	62	7	55	58	4 (dy raste gabim donacion) ²¹	28	34 (2 raste gabim kanë dhënë donacion keq deklarim)
2022	114	30	84	107	7 (një nga ta ka transferuar pjesërisht)	31	83

Nga shënimet të cilat kemi pranuar për këto 45 biznese nga ATK, rreth 490,347 euro nuk janë transferuar në llogari të organizatave sportive dhe as nuk janë paguar shtetit si tatim i obliguar. Po ashtu nga kjo analizë e të dhënave shihet se nga mostrat e përzgjedhura 45 klube kanë përfituar sponsorizim në vlerë prej 1,083,246 euro duke mos poseduar vërtetim nga MKRS për sponsorizim të sportit.

Ndërkaq, nga mostrat e përzgjedhura, 129 klube përfituese të sponsorizimit nuk kanë dorëzuar informatat në ATK sipas ligjit të sponsorizimit.

Për dy rastet të tjera ku kompanitë kanë keq-deklaruar²² në ATK gjatë vitit 2021, as ATK apo MKRS nuk kanë qenë të informuara për këto gabime edhe pse sipas ligjit, 30 ditë pas përfundimit/realizimit të marrëveshjes duhet të raportohet ne ATK.

Nga të dhënat e analizuara më lartë mund të vijmë në përfundim se as ATK e as MKRS nuk kanë informata për gjendjen e sponsorizimit të sportit nga kompanitë private. Sipas ATK-së arsyeja e mos-kontrollit të këtyre bizneseve është sepse sistemi i ATK-së bazohet kryesisht në sistemin e riskut, ku përmes sistemit bëhet kategorizimi i bizneseve me risk të lartë, të mesëm dhe të ulët, që duhet të inspektohen. Po ashtu, duke marrë parasysh edhe numrin e kufizuar të stafit operativ, sipas

²¹ Në këto dy raste kompanitë sipas ATK-së kanë dhënë donacion (deri 10%) dhe kanë deklaruar gabimisht gjatë zbritjes së tatimit.

²² Kompanitë kanë gabuar gjatë plotësimit të raportimit të tyre vjetor në ATK.

ATK-së ka qenë e shtyrë që në rastin e caktimit të kontrolleve tatimore të fokusohet tek bizneset me risk të lartë të evazionit fiskal.

Nga kjo analizë shihet se kompanitë nuk kanë paguar tatimet e obliguara duke iu shmangur me arsyetimin e tyre se kanë dhënë për organizatat sportive.. Bizneset kanë dhënë fonde për organizatat sportive pa ndonjë program të vlerësuar nga MKRS, apo pa vlerësim se shpenzimi i këtyre fondeve do të paraqes interes publik. Organizatat sportive të cilat kanë përfituar fonde pa vërtetim, nuk kanë raportuar në MKRS dhe ATK se për çfarë qëllimi i kanë shpenzuar këto fonde.

ATK nuk ka ofruar ndonjë informacion nëse kishte gjobitur ndonjë kompani për shkelje të tilla. Por pas diskutimeve tona gjatë auditimit me zyrtarët e ATK-së për parregullsitë e identifikuar, ATK ka gjobitur vetëm dy kompani për mos deklarim të saktë të tatimeve. Kontrolli ju është referuar kompanive të cilat kishin deklaruar zbritje në tatim pa u pajisur me vërtetim nga MKRS. Lirimi nga tatimi i kompanive pa vërtetime nga MKRS me qëllim të sponsorizimit të aktiviteteve sportive në vlerë 1,083,246 euro dhe po ashtu, mos transferimi i mjeteve për sponsorizim në klube në vlerë 490,347 euro, ka shkaktuar dëmtim të buxhetit të vendit në shumën prej 1,573,593 euro për vitet 2020-2022.

3.2 Financimi përmes subvencionimit përgjatë viteve 2020-2022

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë subvencionon federatat, klubet dhe sportistët individualë me mjete financiare për të promovuar dhe zhvilluar sportin në Kosovë. Subvencione janë dhënë për të ndihmuar federatat sportive në organizimin e aktiviteteve, trajnimeve, kampionateve dhe për të përmirësuar infrastrukturën sportive. Kriteret dhe shuma e subvencioneve mund të ndryshojnë në varësi të politikave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë, si dhe në bazë të projekteve specifike të prezantuara nga federatat sportive.

3.2.1 Vonesa në caktimin e koeficientit për federata

MKRS-ja për financimin e federatave sportive përdor rregulloren për kategorizimin e sporteve²³. Sportet kategorizohen në katër kategori: Grupi A i cili përfshin federatat kombëtare, të cilat kanë grumbulluar 65 pikë, Grupi B përfshin federatat kombëtare, të cilat kanë grumbulluar 45 - 64.99 pikë, Grupi C përfshinë federatat kombëtare, të cilat kanë grumbulluar 25 - 44.99 pikë dhe Grupi D përfshinë federatat kombëtare, të cilat kanë grumbulluar deri në 24.99 pikë. Ndërsa vlera financiare e poentimit caktohet çdo vit me vendim të Ministrit.

Ministri çdo vit cakton vlerën financiare të koeficientit për financim të federatave sportive dhe ky koeficient shumëzohet me pikët të cilat ka fituar federata gjatë kategorizimit. Nga analiza e dokumenteve të caktimit të vlerës së koeficientit të financimit, kemi gjetur se vlera financiare për vitin 2020 është caktuar në mars, për vitin 2021 në maj dhe për vitin 2022 në mars

Sipas MKRS-ës kjo ka ndodhur për shkak se, me shpalljen e listës preliminare, sipas rregullore, Federatat Sportive kanë afat prej 8 ditësh për të parashtruar ankesat e tyre. Më pas KOK-u, ka edhe 8 ditë tjera të punës për të shpallur listën finale të kategorizimit. Pra, nga momenti i mbylljes së afatit për aplikim, deri në publikimin e listës përfundimtare, sipas rregullore së vjetër, procesi zgjatë 47

²³ Rregullore (mkrs) nr. 04/2018 per kategorizimin e sporteve

ditë pune. Megjithatë, vlerësojmë se këto përcaktime janë bërë me vonesë për shkak se disa federata i zhvillojnë aktivitetet sportive gjatë periudhës së dimrit. Po ashtu, financimi i federatave sportive bëhet përmes katër tre-mujorëve dhe tremujori i parë (TM1) duhet të përfundojë në mars dhe të raportohet në prill. Gjatë viteve 2020-2022, kategorizimi dhe financimi i federatave ka filluar pas muajit prill, kjo shkakton që tremujorin e parë (TM1) organizatat sportive në vend se ta pranojnë subvencionimin në mars ato e pranojnë në maj apo me vonë. Kjo e ka vështirësuar raportimin e tyre dhe përmbylljen e të gjithë tre-mujorëve. Po ashtu, edhe në kategorizimin e sporteve me pikë kemi gjetur se ka vonesa.

Vlen të ceket që, në vitin 2023 me të njëjtën mënyrë të vlerësimit ka përmirësime në procesin e caktimit dhe vlerësimit të federatave sportive.

Duke marrë parasysh që financimi i federatave sportive është i ndarë në katër tremujorë, ku tremujori i parë (TM1) përfundon në mars ndërsa financimi ka filluar pas prillit, kjo ndikon në mospërputhje me periudhën raportuese, duke e bërë të vështirë për federatat raportimin dhe mbylljen e të tre muajve.

3.2.2 Financimi i përfaqësuesve të Federatave sportive është përcjellur me mangësi

MKRS përkatësisht departamenti i Sportit mbanë regjistrin e Federatave të sportit të licencuara në Kosovë. Federatat e cila themelohet për degën e caktuara të sportit, sigurojnë të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë pas licencimit në departamentin e sportit në MKRS.²⁴

Federatat sportive në Kosovë nga viti 2020 deri me 25 tetor 2022 nuk kanë qenë të licencuara. Ato kanë filluar të licencohen me radhë nga data 25 tetor 2022. Edhe pse federatat nuk kanë qenë të licencuara dhe nuk kanë pasur të drejtë të zhvillojnë aktivitetet sportive dhe të financohen nga MKRS apo sponsorizimi, MKRS ka financuar këto federata edhe gjatë kësaj periudhe kohore. Bazë për këtë financim është marr vendimi i ministrit i datës 30.04.2021 për vazhdimin e vlefshmërisë së licencave të federatave sportive, duke u bazuar në rekomandimin e komisionit për licencimin e federatave. Ky komision kishte kërkuar që për shkak të rrethanave të COVID-19, e cila ka pasur ndikim që federatat të mos arrijnë të përmbushin kriteret e licencimit dhe po ashtu, për të mos humbur mundësinë e marrjes pjesë në lojërat olimpike Tokio 2020 (që janë shtyrë për vitin 2021) dhe në kampionatet ballkanike, evropiane dhe botërore, MKRS në bazë të autoritetit të saj ka vendosur që vlefshmëria e licencave të jetë deri më 31 dhjetor 2021. Gjithashtu, me vendim të ministrit me datë 19.05.2022 i është vazhduar licenca federatave sportive deri me 31.07.2022. Edhe pse ky vendim kishte afat deri me 31.07.2022 federatat sportive janë financuar edhe pas kësaj date dhe pa licenca operimi. Rregullorja aktuale nuk e parashihet vazhdimin e licencave të organizatave sportive, vetëm lejohet ri-licencimi i tyre duke plotësuar kriteret e parapara ligjore. Licencimi sipas standardeve do të mundësonte financimin vetëm të federatave të cilat plotësojnë kriteret dhe zhvillojnë aktivitete sportive.

²⁴ UA Nr. 02/2015 për themelimin dhe licencimin e federatave dhe shoqërive sportive, Neni 12

Gjatë analizimit të financimit të federatave me memorandume bashkëpunimi apo për pjesëmarrje në gara, 2.4 milion euro iu janë dhënë federatave pa licencë. Federata e parë e cila është licencuar në MKRS është licencuar me datën 25 tetor 2022 ndërsa MKRS ka financuar këto federata për aktivitetet e tyre sportive prej muajit shkurt 2022.

Zyrtarët në MKRS cekin se për të tejkaluar ngërçin lidhur me mbështetjen e organizatave sportive të pa licencuara për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare ju është mundësuar financimi përmes ombrellës së KOK-ut. Kjo në mënyrë që mos të humbin pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare kualifikuese që ishin të obligueshme për të arritur normat olimpike dhe kualifikimet për kampionate Botërore dhe Evropiane. Kjo nuk e arsyeton financimin për shkak se MKRS dhe KOK do duheshin të parapërgatiten lidhur me licencimin e federatave në mënyrë që të i mundësohet financimi i tyre në bazë të pikëve të fituara.

3.2.3 Financimi i organizatave sportive nuk është i rregulluar qartë

KOK-u çdo vit bën kategorizimin me pikë të federatave sportive dhe ky kategorizim duhet të bazohet në cilësinë, masivitetin, statusin, aktivitetet dhe ngritjen e kapaciteteve. Pastaj MKRS çdo vit përcakton vlerën financiare të koeficientit për financimin e federatave sportive.²⁵

Gjatë analizimit të mostrave për vitet 2020-2022 kemi vërejtur se organizatat sportive marrin subvencion shumë herë më të lartë se sa kanë merituar në bazë të pikëve të bazuara në rregullore për kategorizimin e federatave sportive.

Nga llogaritja e diferencës ndërmjet shumës së cilës organizatat sportive kanë merituar në bazë të pikëve të fituara dhe financimit real gjatë vitit 2020, shihet se ka një dallim për 805,498 € më shumë se sa organizatat sportive që e kanë merituar në bazë të kriterëve. Pra për 2020, MKRS kishte financuar 15 federata sportive më shumë se sa e kanë merituar në bazë të sistemit të pikëve (aneks tabela 8).

Për vitin 2021 (aneks tabela 10) organizatat sportive janë financuar në shumën rreth 1.4 milion euro më shumë se sa kanë merituar në bazë të pikëve. Po ashtu, gjatë këtij viti ka raste kur federata me aneks memorandum ka përfituar 6 herë më shumë subvencion se sa ka merituar.

Gjatë vitit 2022 (aneks tabela 11) organizatat sportive janë financuar rreth 582,370 euro më shumë se sa kanë merituar në bazë të pikëve.

Ne kemi analizuar bazën e këtyre Aneks memorandumeve dhe nuk kemi gjetur se kjo formë e financimit është e rregulluar me akte nënligjore siç është e rregulluar forma e financimit të federatave përmes pikëve. Kjo formë e financimit të organizatave sportive e pa rregulluar me akte nënligjore paraqet financim jo të barabartë në krahasim me organizatat tjera sportive të cilat kanë përfituar më shumë pikë në bazë të rezultateve të arritura në vitin paraprak.

Ne kemi pyetur zyrtarët e MKRS lidhur me financimin jashtë memorandumeve bazë dhe ata janë përgjigjur se MKRS përmes memorandumeve të veçanta ka financuar organizatat sportive për

²⁵ Rregullore (MKRS) nr. 04/2018 për kategorizimin e sporteve

aktivitete të ndryshme siç janë për organizimin e ngjarjeve ndërkombëtare etj. Financimi në këtë formë duke mos i përfillur kriteret e pikëve dhe koeficientin e MKRS-së paraqet një sistem të vlerësimit jo të drejtë në krahasim me federatat tjera të cilat janë vlerësuar në bazë të pikëve.

3.2.4 Avancet e pa mbyllura të federatave dhe klubeve sportive të cilat kanë përfituar në vitin 2020-2022

Në marrëveshjen e memorandumit ndërmjet MKRS dhe federatave sportive²⁶ ceket se organizatat sportive kanë obligim të raportojnë çdo tre muajor një raport narrativ për shpenzimin e mjeteve sipas realizimit të aktiviteteve sportive në MKRS dhe të alokoj mjetet për tre muajorin e radhës.

Nga analizat e subvencionimeve të MKRS-së, shihet se ka shuma të mëdha të mos raportimeve të subvencioneve të cilat ndan MKRS. Pra sa i përket raportimit, organizatat sportive nuk qëndrojnë mirë lidhur me raportimin e shpenzimit të financave. Kjo ka ndodhur për shkak se MKRS nuk ka tentuar t'i mbaj përgjegjës organizatat sportive për raportim dhe mbyllje të avanceve.

Tabela 4: shuma e financuar e raportuar dhe e pa-raportuar.

Viti	Shuma e financimit	Të raportuara	Të pa-raportuara
2020	4,150,273 €	2,919,248 €	1,231,025 €
2021	4,405,777 €	4,210,459 €	195,318 €
2022	5,275,959 €	3,179,733 €	2,096,226 €

Tabela lartë paraqet shumën financiare e të gjitha federatave sportive klubeve dhe raportimet e tyre.

Viti 2020

Nga vlera e përgjithshme e financimit e cila ishte 4.1 milion euro për organizatat sportive, rreth 1.2 milion euro, apo 39 organizata sportive (tabela 7 aneks) nuk kanë raportuar në MKRS se si i kanë shpenzuar këto fonde publike dhe për çfarë qëllime i kanë shpenzuar. Po ashtu, nuk kanë raportuar për rezultatet e arritura, edhe pse ligjërisht ishin të obliguara që të raportojnë me së largu deri në fund të vitit 2020.

Nga analiza e 17 mostrave të vitit 2020, 10 organizata sportive të cilat kanë përfituar në vitin 2020 nuk kanë raportuar në MKRS dhe kanë përfituar sërish në vitet tjera 2021 dhe 2022. Po ashtu, këto 10 organizata sportive, avancet e përfituara figurojnë të hapura edhe në vitin 2022.

Nga analiza e listave të subvencionimit të organizatave sportive, dy federata sportive janë subvencionuar me memorandum bazë edhe pse nuk i kishin të mbyllura avancet për vitin 2020.

²⁶ Memorandum bashkëpunimi MKRS federata sportive neni 5 pika 5.7

Tabela 5: Financimi i organizatave sportive pa mbyllur avancet.

Viti	Federata	Shuma	Raportimi
2020	Federata e Sportive 1	13,707€	Avanc
2021	Federata e Sportive 2	18,276 €	Mbyllur
2020	Federata e Sportive 3	4,530 €	Avanc
2021	Federata e Sportive 4	5,663 €	Avanc
2022	Federata e Sportive 5	8,900 €	Avanc

Njëra federatë kishte përfituar financim në vitin 2021 në shumë prej 5,663 euro me memorandum bashkëpunimi e për të cilat fonde nuk kishte raportuar asnjëherë. Po ashtu, kjo federatë ka përfituar subvencion edhe gjatë vitit 2020 me vlerë prej 4,530 euro e të cilin ende nuk e ka të raportuar në MKRS se si e ka shpenzuar.

Edhe pse federatat nuk raportojnë për shpenzimin e fondeve të memorandumëve bazë ato në vazhdimësi përfitojnë nga MKRS financime me aneks memorandumë. Po ashtu federatat dhe klubet sportive as për llojet tjera të financimit, nuk raportojnë se në cilat drejtime i kanë shpenzuar dhe nuk dihet a i kanë realizuar ato aktivitete të parapara për të cilat i kanë përfituar fondet.

Një klub sportiv ka përfituar subvencion në vlerë prej 9,315 euro për aktivitetin “Mbështetje Financiare Java Evropiane e sportit - 2020” në vitin 2020 përderisa themeluesit e këtij klubi janë zyrtaret e MKRS konkretisht nga departamentin i sportit. Po ashtu, i njëjti zyrtar kishte përfituar vërtetim sponsorizimi nga MKRS në vitin 2020 në vlerë prej 7,000 euro, ndërsa për vitin 2022 kishte përfituar 3 vërtetime në vlerë prej 17,000 euro.

Viti 2021

Nga 39 mostrat e analizuar për vitin 2021, 10 organizata sportive kanë përfituar edhe në vitin 2022 edhe pse përfitimin e vitit 2021 nuk e kanë të mbyllur. Po ashtu nga 39 përfitues të vitit 2021, 22 prej tyre kanë avance ende të pa mbyllura prej vitit 2020.

Përveç financimeve të federatave me memorandumë MKRS-ja në vitin 2021 ka financuar klubet sportive me thirrje publike. Ne kemi analizuar gjashtë mostrat dhe kemi vërejtur se të gjitha këto janë avance të pa mbyllura. Vlera e tyre ishte në shumë prej 217,809 euro.

Nga përfituesit e subvencionimit në MKRS kemi hasur se MKRS ka vazhduar me trendin e njëjtë të financimit të organizatave sportive që përfitojnë fonde publike dhe nuk i raportojnë shpenzimin e tyre. Nga shuma e financimit të vitit 2021 prej 4.4 milion euro, MKRS ka subvencionuar organizatat sportive me aneks memorandumë në shumën prej 872,648 euro.

Në total MKRS në vitin 2021 ka financuar organizatat sportive apo sportistët me shumën prej 4,4 milion euro. Prej tyre 195,318 euro nuk janë raportuar në MKRS nga organizata të ndryshme sportive se si i kanë shpenzuar këto fonde edhe pse e kanë pasur obligim ligjor raportimin e tyre.

Viti 2022

Vlera e përgjithshme e financimit të MKRS për organizatat sportive për vitin 2022 ka qenë 5.2 milion euro. Nga kjo vlerë, 2 milion euro janë avance të hapura dhe nuk janë të raportuara në MKRS.

Ne kemi përzgjedhur 19 mostra të financimit të organizatave sportive për vitin 2022 të cilët janë subvencionuar në vlerën prej 1.6 milion euro. Nga kjo vlerë, 641,323 euro janë avance të pa mbyllura nga 11 organizata sportive, ndërsa 940,384 euro janë raportuar për shpenzimet e fondeve të tyre në MKRS nga 8 organizata sportive.

Nga mostrat e analizuara të përfitueseve të vitin 2022 kemi hasur se këto organizata sportive kanë avance të pa mbyllura në vitin 2020 dhe 2021 të paraqitura në tabelën më poshtë.

Tabela 6: organizatat sportive të cilat kanë përfituar edhe në vitin 2022 me avance të pa mbyllura të vitit 2020 dhe 2021.

Federatë/Klubë sportiv	Shuma e perfituar në 2022	Raportimi për 2022	Avancet e hapura nga 2020	Avancet e hapura nga 2021
1. Federatë sportive 1	358,945 €	Mbyllur	2	1
2. Federatë sportive 2	178,000 €	Avanc	2	0
3. Federatë sportive 3	169,460 €	Avanc	2	1
4. Federatë sportive 4	142,072 €	Avanc	1	0
5. Federatë sportive 5	43,758 €	Mbyllur	2	0
6. Federatë sportive 6	43,176 €	Mbyllur	2	0
7. Federatë sportive 7	39,640 €	Avanc	2	1
8. Klub Sportiv 8	10,000 €	Avanc	0	0
9. Klub Sportiv 9	10,000 €	Avanc	0	0
10. Klub Sportiv 10	10,000 €	Avanc	0	0
11. Klub Sportiv 11	10,000 €	Avanc	0	0
12. Federatë sportive 12	43,176 €	Mbyllur	2	0
13. Federatë sportive 13	42,951 €	Mbyllur	2	1
14. Federatë sportive 14	42,951 €	Avanc	2	1
15. Federatë sportive 15	24,435 €	Mbyllur	0	0
16. Klub Sportiv 16	10,000 €	Avanc	0	0
17. Federatë sportive 17	358,945 €	Mbyllur	2	1
18. Federatë sportive 18	25,000 €	Mbyllur	0	0
19. Klub Sportiv 19	19,200 €	Avanc	0	0

Tabela 6 paraqet federatat sportive, të cilat kanë avance të pa mbyllura edhe nga vitet 2020 dhe 2021. Pra, si shembull, nëse e analizojmë federatën sportive 1, shihet se kjo federatë ka raportuar për fondet e përfituara për vitin 2022, por ka dy avance të pa mbyllura për vitin 2020 dhe një avancë për vitin 2021. Gjithashtu nga mostrat e analizuara kemi edhe 6 organizata sportive të cilat kanë përfituar me thirrje publike e të cilat nuk i kanë raportuar se si i kanë shpenzuar këto fonde. Të dhënat e paraqitura me lartë për të tre vitet 2020, 2021 dhe 2022 pasqyrojnë gjendjen e raportimit të organizatave sportive deri në korrik të vitit 2023.

Kjo formë e financimit të organizatave sportive dhe mos përgjegjshmëria e tyre lidhur me shpenzimin e fondeve për vitet 2020-2022 ka ndikuar që MKRS të mos ketë informata se si janë shpenzuar fondet publike prej rreth 3,5 milion euro. Sipas zyrtarëve të MKRS-së, nuk ndahen fonde për organizata sportive pa i mbyllur projektet e kaluara. Mirëpo, dëshmitë audituese tregojnë se edhe pse nuk janë financuar me memorandume bazë, ato organizata të cilat kanë pasur avance të pa mbyllura janë financuar përmes aneks marrëveshjeve apo formave tjera të financimit në shumë prej 1,3 milion euro për vitet 2021 dhe 2022. Për më shumë, nuk kemi gjetur se kjo formë e financimit

është e rregulluar me akte të brendshme administrative ashtu siç janë të rregulluar format tjera të financimit .

Mungesa e raportimit të fondeve publike nga ana e federatave sportive dhe klubeve nuk siguron se këto fonde publike janë përdorur për qëllimet të cilat janë përfituar, po ashtu nuk i ofron MKRS-së informata për rezultatet e sportit në vend.

3.2.5 Financimi i organizatave sportive pa thirrje publike për vitin 2020

Çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet me thirrje publike, e cila duhet të publikohet në ueb faqen e ofruesit të mbështetjes financiare. Ofruesit e mbështetjes financiare inkurajohen të përdorin edhe forma tjera për njoftimin të OJQ-ve, me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë.²⁷

Nga analiza e mostrave të vitit 2020 kemi identifikuar se organizatat sportive financohen edhe pa thirrje publike. Nga mostrat të cilat i kemi përzgjedhur, janë dy raste ku organizatat sportive janë financuar vetëm me kërkesë drejtuar MKRS-së.

Këto dy organizata sportive kanë përfituar pa ndonjë thirrje publike në vlerë prej 21,100 euro, duke mos kërkuar plotësimin e kriterëve sipas ligjit dhe rregullores së MKRS-së. Sipas MKRS-së, këto dy klube kanë zhvilluar aktivitete me interes për sportin në vend. Njëra nga këto rastet, për herë të parë ka arritur të kualifikohet në garat ndërkombëtare Champions League në kuadër të UEFA, ndërsa tjetra është anëtar i Federatës të Basketbollit të Kosovës dhe Federatës Internacionale e Basketbollit (FIBA) të cilat kanë pasur obligim organizimin e garave për kualifikimet ndërkombëtare. Edhe pse MKRS ka përkrahur aktivitetet e tilla kjo formë e financimit të organizatave sportive apo aktiviteteve të tyre duhet të jenë të rregulluara dhe të kenë kriteret e qarta për përfituesit e fondeve, lidhur me aktivitete të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare. Pra kjo formë e financimit duhet të jetë transparente dhe t'i mundësohet secilës organizatë sportive apo individit të cilët kualifikohen për gara ndërkombëtare që të financohen për organizimin e këtyre aktiviteteve.

Financimi i organizatave pa thirrje publike përveç se është jo transparente po ashtu ndikon që përfituesi të mos trajtohet i barabartë me organizatat tjera sportive dhe të mos ketë konkurrueshmeri ndërmjet organizatave sportive.

3.2.6 Keq menaxhim i projektit data-baza sportive e Kosovës

Përmes shpalljes publike të MKRS në dhjetor 2021 një OJQ kishte përfituar subvencion në vlerë prej 121,430 euro për zhvillimin e projektit “Databaza Sportive e Kosovës”. Këtë projekt përfituesi duhej ta realizonte brenda gjashtë muajve përkatësisht deri më 30.06.2022. Objektivat e projektit ishin:

- Posedimi i të dhënave për krijimin e një data-baze në ndonjë platformë më të avancuar,
- Monitorimi afatgjatë i trendëve të pjesëmarrjes në sport dhe disponueshmerisë së stafit mbështetës në klubet sportive,

²⁷ rregullore mf - nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe Procedurat e financimit publik të oj-q-ve

- Trajnimin e stafit për mbledhjen e të dhënave dhe sistemimi i tyre, të cilët do të mund të angazhohen në të ardhmen për qëllime të kësaj natyre,
- Publikimi i rezultateve në nivel kombëtar (Raport final, konferenca përfundimtare, mediat).

Produkti/raportin final i OJQ-së i janë siguruar auditorit vetëm pas dërgimit të draft raportit të auditimit në Ministri dhe në bazë të dëshmimeve rezulton se ky produkt ishte dërguar në Ministri me datën 16.06.2023, rreth një vit me vonesë. Ministria produktin në fjalë nuk e ka pranuar përmes komisionit për të vlerësuar nëse produkti i përmbush objektivat e parapara dhe rrjedhimisht avanci për këtë subvencion është ende i hapur. Në dosje, kishte dëshmi se MKRS kishte refuzuar ta mbyllte avancin për këtë projekt për shkak të paqartësive rreth cilësisë së projektit. Për më shumë, edhe në vlerësimin e aplikacionit për subvencionim ishte e nënshkruar vetëm nga njëri anëtarë i komisionit. Megjithatë, lista përfundimtare e të gjithë përfituesve përfshirë këtu edhe përfituesin për këtë projekt ishte nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Duke marrë parasysh që Ministria nuk e ka shfrytëzuar as shqyrtuar raportin final të përfituesit edhe pas afër 9 muajve për të cilin kishte paguar 121,430 euro, tregon për keq menaxhimin e të gjithë procesit lidhur me këtë subvencionim dhe rrjedhimisht mos arritje të vlerës për paranë e shpenzuar.

3.2.7 Mungesa e monitorimit të fondeve të subvencionuara dhe sponsorizuara

Sipas rregullores²⁸ krahas monitorimit të rregullt²⁹, përmes raporteve të dorëzuara, ofruesit e mbështetjes financiare publike bën monitorimin në terren, dhe atë se paku për projektet që janë më të gjata se një vit, duhet të kryhet të paktën një vizitë në terren brenda një viti; dhe për projektet me kohëzgjatje më të shkurtër se një vit, duhet të bëhet të paktën një vizitë në terren gjatë zbatimit të projektit.

Monitorimi duhet të sigurojë informacion mbi: rregullsinë e shpenzimit të fondeve, realizimin e aktiviteteve nga fondet, rezultatet e arritura përmes implementimit të fondeve, dhe ndikimet e këtyre fondeve.³⁰

MKRS duhet të bëjë monitorimin e rregullt të mbështetjes financiare publike për sponsorizimin e sportit, me qëllim që ato të jenë në linjë me kërkesat e marrëveshjes, dhe të arrijë qëllimin për të cilin është ofruar mbështetja financiare apo vërtetimi për përfitim nga bizneset.

MKRS nuk ka sistem i cili verifikon apo vërteton se aktivitetet e subvencionuara arrijnë qëllimet e tyre dhe realizohen. Nga mostrat e analizuara përveç që një pjesë e madhe e organizatave sportive nuk raportojnë, ato të cilat raportojnë përgatitin një raport narrativ i cili është shumë i thjeshtë dhe nuk përmbajnë dëshmi shtesë. Ndërsa, pas përfundimit të të gjitha tre mujoreve ato përgatisin një raport i cili përmban të gjitha dëshmitë e realizimit të aktiviteteve sportive. Po ashtu, MKRS nuk ka ofruar dëshmi të cilat sigurojnë se aktivitetet sportive të cilat i financon arrijnë qëllimin e duhur dhe përdoren për aktivitete sportive, pra nuk ka monitorim fizik të organizatave sportive për të vlerësuar se ato aktivitete realizohen në terren.

²⁸ Rregullore mf - nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe Procedurat e financimit publik të oj-q-ve

²⁹ Po aty neni 24

³⁰ Rregullore mf - nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të oj-q-ve

Sipas zyrtarëve në MKRS si pasojë e kapaciteteve të tyre të limituara me staf nuk kanë mundësi monitorimi të aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë periudhës 2020-2022, Ministria nuk ka zhvilluar asnjë monitorim të aktiviteteve të sponsorizuara.

MKRS nuk ka caktuar asnjë person për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të sponsorizuara. Mungesa e një strukture të përcaktuar për këtë detyrë në MKRS ka krijuar një mangësi në monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të objektivave të këtyre projekteve të sponsorizuara.

Nga raportet e sponsorizmit të cilat dorëzojnë organizatat sportive dhe nga komunikimi me zyrtarët e MKRS-së kemi identifikuar se asnjë zyrtar nuk është përgjegjës për monitorimin e aktiviteteve të sponsorizuara. Kjo situatë paraqet një mangësi serioze në sistemin e monitorimit, duke bërë që MKRS-së t'i mungojë informacioni i nevojshëm për të bërë një vlerësim të saktë të realizimit të objektivave të këtyre sponsorizimeve.

Mungesa e monitorimit të zbatimit të aktiviteteve sportive nuk jep siguri se ato aktivitete të financuara nga MKRS dhe të sponsorizuara nga kompanitë private, zbatohen dhe arrijnë rezultatet e planifikuara dhe nuk ka siguri se ato fonde përdoren për aktivitetet e parapara.

Konkluzionet

Auditimi nxjerr në pah mangësi në financimin e organizatave sportive nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. MKRS nuk ka arritur t'i mbajë përgjegjës organizatat të cilat i financon dhe ato që përfitojnë vërtetim nga sponsorizimi nga kompanitë private. Mungesa e koordinimit ndërmjet MKRS dhe Administratës Tatimore të Kosovës ka lejuar parregullsi të konsiderueshme financiare, duke rrezikuar transparencën, integritetin dhe efektivitetin e financimit të sportit dhe si rezultat buxheti i shteti është dëmtuar.

Janë mbi 3.5 milion euro të cilat MKRS ka subvencionuar organizatave sportive për vitet 2020-2022 e për të cilat MKRS nuk ka informata se si janë shpenzuar dhe cilat janë rezultatet e arritura. Po ashtu një pjesë e madhe e organizatave sportive nuk kanë raportuar se si i kanë shpenzuar fondet publike dhe kanë përfituar në vazhdimësi. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) nuk ka arritur t'i identifikoj dhe gjobisë kompanitë të cilat janë liruar nga tatimi për sponsorizim e që në fakt nuk i kanë dhënë fondet për sponsorizim. Nga mostrat e analizuara në ATK kemi vërejtur se rreth 1,573,246 euro është dëmtuar buxheti i shtetit. Në këtë vlerë hynë 490,347 euro që janë liruar bizneset nga tatimi dhe këto fonde nuk janë transferuar në klube, ndërsa rreth 1,083,246 euro bizneset kanë sponsorizuar klubet pa u pajisur me vërtetim nga MKRS.

Një OJQ përfituese e projektit "databaza sportive në Kosovë" nuk ka dorëzuar produktin/raportin final me kohë për të cilin Ministria kishte paguar 121,430 euro. Për më shumë, edhe pas dorëzimit të produktit, Ministria as nuk e ka shqyrtuar e as pranuar të njëjtin përmes komisionit për të vlerësuar apo maksimizuar përfitimin nga ky projekt. Për pasojë, vlera për paranë e shpenzuar nuk është materializuar. MKRS nuk ka strategji për zhvillimin e sportit dhe kjo ka ndikuar në mos përcaktimin e prioritetëve dhe qëllimeve se ku duhet të përqendrohet Ministria për të arritur progres në fushën e sportit.

Financimi i sportit nga fondet e MKRS-së është karakterizuar nga mungesa e llogaridhënies dhe transparencës. Gjatë vitit 2020-2022, rreth 54 organizata sportive nuk kanë raportuar shpenzimet e tyre. Kjo mungesë e transparencës dhe pa-përgjegjshmëria e organizatave sportive është bërë e dukshme përmes shkeljeve të afateve të mbylljes së projekteve dhe financimeve të marra shtesë si aneks memorandume për të cilat nuk kemi gjetur se është e rregulluar me akte nënligjore për financime të tilla.

Financimi nga sponsorizimi përgjatë viteve 2020-2022 vetëm 64% e përfitueseve të sponsorizimit kanë raportuar shpenzimet e tyre, ndërsa 36% nuk kanë raportuar fare. Në rastet kur ato kanë raportuar në kemi gjetur se disa nga fondet e sponsorizimit përdoren për favorizimin e kompanive sponsorizuese siç janë reklamimi i kompanive, blerja e biletave për ndeshje për stafin e kompanive sponsorizuese, bileta avioni dhe akomodimi për staf të kompanive private. Kjo praktikë ka ndikuar që fondet publike të mos përdoren për qëllimet e sportit.

Gjetjet tregojnë se MKRS nuk ka menaxhuar dhe monitoruar financimin e organizatave sportive, duke çuar në mungesë të llogaridhënies dhe transparencës. Aktivitetet e subvencionuara dhe sponsorizuara nga kompanitë private nuk kanë arritur qëllimet e tyre dhe nuk janë realizuar siç ishin paraparë gjatë fazës së përfitimit. Për më tepër, ka mungesë të dëshmive që vërtetojnë se këto kontribute financiare në mënyrë efektive kanë përmirësuar cilësinë e sportit në Kosovë.

MKRS nuk ka një strukturë të përcaktuar për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të sponsorizuara dhe subvencionuara dhe si pasojë gjatë periudhës 2020-2022 nuk ka zhvilluar asnjë monitorim. Po ashtu, mangësitë në monitorimin e nga ana e MKRS-së dhe ATK-së kanë rezultuar në humbje të konsiderueshme financiare për shtetin, duke përfshirë lirim me të lartë nga tatimi dhe shmangie tatimore nga disa kompani. Mos koordinimi në mes të MKRS-së dhe ATK-së lidhur me pajisjen e klubeve me vërtetime dhe monitorimin e tyre me kohë, ka lënë hapësirë për shkelje dhe mosrespektim të ligjit.

Rekomandimet

Me qëllim që të krijohet një sistem i cili do të ndihmonte që fondet e dhëna për sponsorizim dhe subvencionim të përdoren për aktivitete sportive dhe të arrijnë që sporti në vend të përfaqësohet sa më mirë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar, MKRS dhe ATK duhet të zbatojnë rekomandimet në vijim:

Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

1. Të gjitha aktivitetet e sponosrizuara dhe subvencionuara duhet të jenë të bazuara në strategjinë për sport e cila garanton ngritjen e cilësisë së sportit në vendin tonë.
2. Gjatë aplikimit të organizatave sportive për vërtetim të sponsorizimit forma e aplikacionit ndërmjet sponsorit dhe organizatës sportive duhet të jenë të detajuara në aktivitete, dhe të pranohen nga MKRS vetëm aktivitetet të cilat paraqesin interes publik për zhvillimin e sportit në vend.
3. Të ketë formë të standardizuar të raportimit të sponsorizimit nga organizatat sportive dhe të pranohen vetëm fondet të cilat janë shpenzuar për aktivitete sportive dhe të cilat do të zhvillohen në të ardhmen.
4. MKRS duhet të sigurohet që komisioni i vlerësimit të aplikacioneve për vërtetim të sponsorizimit dhe komisioni për pranim të raporteve të sponsorizimit të mos kenë konflikt të interesit dhe për të siguruar paanshmëri.
5. Të kërkohet kthimi i mjeteve për të gjithë organizatat sportive të cilat nuk arrijnë ti raportojnë shpenzimet e subvencionuara dhe sponsorizuara.
6. Të zhvillojë një sistem efikas të monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të sponsorizuara dhe subvencionuara në fushën e sportit për të siguruar se qëllimet për të cilat janë marrë fondet janë arritur.

Për Administratën Tatimore të Kosovës:

7. Gjatë deklarimit të zbritjes në ATK përveç deklaratës së shumës së raportimit të kërkohet edhe vërtetimi i sponsorizimit dhe transferit bankar drejt organizatës sportive.
8. Të monitoroj kompanitë të cilat kanë dhënë fonde për të siguruar se nuk ka kthim të mjeteve në drejtim të kompanive sponosrizuese nga organizatat sportive.

Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Administratën Tatimore të Kosovës:

9. Të koordinohen për zbatimin e ligjit të sportit dhe për të adresuar problemet të cilat hasin gjatë këtij procesi.
10. MKRS të përcjell vërtetimet e lëshuara në lidhje me shpenzimet që nuk janë pranuar për qëllimet e dhëna ndaj organizatës sportive dhe të informojnë ATK-në në mënyrë që këto organizata të kthejnë fondet e papranuara.

Shtojca I Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Motivi i Auditimit

Ministria ofron mbështetje financiare për federatat sportive të vendit për të arritur objektivat dhe synimet e tyre si pjesë e përpjekjeve për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe sportit. Kjo mbështetje jepet çdo vit përmes subvencioneve dhe memorandumëve të bashkëpunimit, në përputhje me politikat programore të Ministrisë dhe Ligjin për Sport .

Në vitin 2020, Ministria ka ofruar mbështetje për 39 federata sportive dhe KOK-un. Megjithatë, raporti nga Zyra Kombëtare e Auditimit identifikoi disa çështje. Në 10 raste, subvencionet në vlerë prej 287,658 euro janë dhënë pas kryerjes së aktiviteteve, ndërsa avanset ende nuk ishin mbyllur apo shpenzimet ende nuk ishin arsyetuar. Në gjashtë raste janë dhënë subvencione në vlerë prej 199,075 euro, edhe pse kështu e paradhënies nuk ishin plotësisht të arsyetuara. Kjo tregon për një dobësi gjatë proces të monitorimit dhe verifikimit të përdorimit të fondeve.

Raporti gjithashtu ka identifikuar katër raste me mangësi në arsyetimin e shpenzimit në vlerë rreth 80 mijë euro nga fondet e MKRS. Në dy raste, shpenzimet janë justifikuar duke përdorur fatura të vitit paraprak, edhe pse në vitin aktual nuk kishte pasur aktivitete si pasojë e Covid 19. Për mbylljen e tremujorit të katërt të vitit 2019 të Federatës së Basketbollit dhe mbylljen e tremujorit të dytë të vitit 2020 të Federatës së Karatesë, u konstatuan mangësi në justifikimin e shpenzimeve për qëndrimin në hotel, transportin dhe furnizimet me veshje për sportistët, pasi mungonin listat e pjesëmarrësve.

Dhënia e subvencioneve pa plotësuar kriteret e përcaktuara në memorandumet e bashkëpunimit, vonesat dhe mangësitë në mbylljen dhe justifikimin e subvencioneve nga federatat mund të rrisin rrezikun që fondet të përdoren për qëllime të ndryshme nga ato të synuara dhe të pengojnë objektivat e Ministrisë.

Forma tjetër e financimit të sportit është nga tatimet e bizneseve të cilëve iu mundësohet sipas ligjit që deri në 30% e tatimit në fitim ta japin për aktivitete sportive, dhe ajo shumë të zbritet në tatim gjatë raportimit në ATK. Sa i përket këtij procesi, shoqëria civile ka ngritur shqetësimet e tyre se kjo formë nuk ka transparencë nga bizneset dhe organizatat sportive . Po ashtu nga takimet me zyrtaret kompetent në ministri janë ngritur dyshimet lidhur me procesin e financimit të organizatave sportive dhe refuzimit të raportimit të tyre në Ministri lidhur me arritjen e objektivave dhe shpenzimin e fondeve.

Gjithashtu, gjatë fazës parastudimore kemi hasur në pasaktësi të të dhënave në vërtetimet e sponsorizimit nga Ministria. Këto të dhëna të cilat i kemi krahasuar me të dhënat e ATK-së tregojnë një diferencë në shpenzimet e lejuara nga Ministria dhe shuma e zbritur nga bizneset në ATK.

Shqyrtimi i indikatorëve të problemeve të identifikuar më lartë na shprijnë në formulimin e problemit të auditimit si në vijim:

Në bazë të hulumtimeve kemi identifikuar se proceset e financimit raportimit, dhe monitorimit të organizatave sportive përcillen me mangësi të theksuara.

Kriteret e Auditimit

Me kërkesë të shfrytëzuesit të sponsorizimit, Ministria lëshon vërtetim në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës me të cilin vërteton se sponsorizimi në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit është interes i përgjithshëm publik. Ministria në afatin e paraparë, kërkon sqarim për secilën kërkesë të paraqitur, në bazë të kompetencave të veta nga organet përkatëse mbikëqyrëse.³¹

Përfituesi i sponsorizimit mund të jetë person fizik apo juridik vendor i cili në emër të pranimit të sponsorizimit, duhet t'i realizoj detyrimet të cilat dalin nga marrëveshja e nënshkruar për sponsorizim³². Sponsorizuesit për aktivitetet e sportit u njihet zbritja 30% nga tatimi në fitim sipas këtij ligji.³³

Për kryerjen e punëve me interes publik, për edukimin fizik e të sportit, Ministria nxjerrë Programin për Zhvillimin e Edukimit Fizik dhe të Sportit për periudhën katër vjeçare.³⁴

Ministria, përcakton politikat e përgjithshme të zhvillimit të sportit, në përputhje me prioritetet e masovizimit dhe të ngritjes së cilësisë së tyre. Ajo krijon kushtet infrastrukturale, financiare dhe kadrovike për përmbushjen e objektivave të caktuara.

Ministria me qëllim të zbatimit të politikave të tyre strategjike në fusha të ndryshme të sportit duhet të zbatojë kriteret e rregulloreve për llojet e financimit në sport siç janë: kategorizimi i sportistëve dhe trajnerëve, financimi i organizatave sportive në bazë të kategorizimit.³⁵

Përfituesi i sponsorizimit obligohet që të hartojë raport me shkrim lidhur me sponsorizimin e realizuar, dhe atë ta dërgojë në Ministri brenda afatit prej tre muajve. Në rastet kur sponsorizimi është afatgjatë, raportimi bëhet në baza vjetore.³⁶

Përfituesi i sponsorizimit obligohet që të hartojë raport me shkrim lidhur me sponsorizimin e realizuar, dhe atë ta dërgojë në Ministrinë për kulturë, rini dhe sport brenda afatit prej tre muajve. Në rastet kur sponsorizimi është afatgjatë, raportimi bëhet në baza vjetore. Në raportin e përmbledhur duhet të përshkruhen të gjitha rezultatet e arritura sipas marrëveshjes përkatëse për sponsorizim, duke i përshkruar afatet kalendarike kur janë realizuar aktivitetet

përkatëse, shumat financiare që janë shpenzuar për ato aktivitete, numrin e përfituesve nga aktivitetet e realizuara. Raportet e dërguara nga përfituesi i sponsorizimit do të vlerësohen nga Komisioni përkatës në kuadër të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i cili e ka lëshuar vërtetimin përkatës për sponsorizim. Të gjithë përfituesit e sponsorizimit në vlerë 10 mijë euro e më shumë janë të obliguar që të sjellin raportin e auditimit për vitin paraprak në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në rast se një përfitues i sponsorizimit nuk e përmbush detyrën e tij për raportim vjetor

³¹ Ligji Nr. 05/L-090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Neni 16).

³² Ligji Nr. 05/L -090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Neni 10, pika 1).

³³ Po aty, neni 12.

³⁴ Ligji nr. 2003/24 Ligji i Sportit (neni 19).

³⁵ Ligji nr. 2003/24 Ligji i Sportit(neni 8)

³⁶ Rregullore (MKRS) nr. 01/2018 për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (neni 12).

lidhur me sponsorizimin e realizuar, nuk do t'i mundësohet trajtimi i lëndëve tjera, si dhe do të sanksionohet³⁷.

MKRS duhet të bëjë monitorimin e rregullt të mbështetjes financiare publike për sponsorizimin e sportit, me qëllim që ato të jenë në linjë me kërkesat e marrëveshjes, dhe të arrijë qëllimin për të cilin është ofruar mbështetja financiare apo vërtetimi për përfitim nga bizneset. Monitorimi duhet të sigurojë informacion mbi: rregullsinë e shpenzimit të fondeve, realizimin e aktiviteteve nga fondet, rezultatet e arritura përmes implementimit të fondeve, dhe ndikimet e këtyre fondeve. Ofruesi i mbështetjes financiare apo vërtetimit për financim nga bizneset, bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë monitorimit të zbatimit të projekteve, kryejnë vlerësimin të mbështetjes së dhënë financiare.³⁸

Marrëveshja për sponsorizim dhe reklamim me raportin financiar detyrimisht dorëzohen në ATK më së largu tridhjetë ditë nga dita e përmbushjes-përfundimit të marrëveshjes. Vërtetimin për përcaktimin e interesit publik për qëllim të realizimit të të drejtave të palëve për sponsorizim, dhe i cili do të procedohet në ATK³⁹ nga palët përfituese prej sponsorizimit, duhet të përmban këto të dhëna: emri dhe titulli i dhënësit dhe i pranuesit, emri dhe titulli i shfrytëzuesit të fundit, përshkrimi i lëndës dhe qëllimit të sponsorizimit i cili mundëson identifikimin e tyre me të dhëna të sakta për sasinë, vlerën dhe vetitë tjera të tij, përdorimi përfundimtar i lëndës së sponsorizimit. ATK - ja dhe organet kompetente (MKRS) mbikëqyrin dhënien, pranimin dhe shfrytëzimin e sponsorizimit dhe reklamimit për zbritjet e lejuara. ATK - ja dhe organet tjera kompetente, në qoftë se gjatë kontrollit vërtetojnë parregullsi dhe keqpërdorime gjatë shfrytëzimit të sponsorizimit mund të parashatrojnë kallëzime penale apo kundërvajtëse sipas legjislacionit në fuqi.⁴⁰

Fushëveprimi i auditimit

Pjesë e fushëveprimit të këtij auditimi janë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Administrata Tatimore e Kosovës. Sa i përket mbështetjes me informata, do të shfrytëzohen të dhënat nga ATK-ja lidhur me lirimin nga tatimi i bizneseve të cilat japin sponsorizime për sport. Në kuadër të Ministrisë do të jetë Departamenti i Sportit dhe Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për vërtetim e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Fushëveprimi do të fokusohet përgjatë viteve 2020-2022.

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve të auditimit, ekipi i auditimit do të kryejnë disa aktivitete në institucionet përgjegjëse duke përdorur një sërë teknikash audituese:

Analizimin e kornizës ligjore dhe rregullatorë të MKRS;

Analizimin e kornizës ligjore dhe rregullatorë të ATK-së;

Intervistimin e personave përgjegjës dhe strukturat udhëheqëse të institucioneve përgjegjëse;

³⁷ Rregullore (MKRS) nr. 01/2018 për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

³⁸ Rregullore mf - nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të oj-q-ve

³⁹ Rregullore (MKRS) nr. 01/2018 për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (neni 12).

⁴⁰ LIGJI Nr. 05/L -090 Për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit (neni 15).

Planet e MKRS-së lidhur me sponsorizimin e sportit në Kosovë;
 Planet vjetore të departamentit të sportit;
 Thirrjet publike për përkrahjen e sportit-ve;
 Raportet mbi gjendjen e Sportit në Kosovë;
 Listat e përfituesve për përkrahje nga MKRS;
 Listat e përfituesve të vërtetimit tatimor nga MKRS e cila paraqet përfituesit e 30% të tatimeve nga bizneset private;
 Raportet e federatave të dorëzuara ne MKRS lidhur me shfrytëzimin e mjeteve për përkrahjen e sportit;
 Raportet lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga klubet sportive të financuara nga MKRS apo indirekt nga federatat me fondet publike apo të bizneseve të cilat lirohen nga tatimi ne fitim, dhe
 Të dhënat relevante nga ATK për bizneset të cilat janë liruar nga tatimi në fitim si pasojë e sponsorizimit në fushën e sportit dhe krahasimi i tyre me të dhënat e Ministrisë për të vërtetuar saktësinë e zbritjes.

Shtojca II Aneks

Tabela 7: financimi i organizatave sportive dhe mos raportimi i tyre në MKRS.

Data	Përshkrimi	Shuma e Subvencionimit	Raportim
02.09.2020	Pastrimi dhe Monitorimi i Liqenit të Batllavës	2,800 €	Avanc
03.09.2020	Mbështetje Financiare	2,150 €	Avanc
26.11.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	499,000 €	Avanc
26.11.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	167,000 €	Avanc
30.11.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	140,000 €	Avanc
20.11.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	57,600 €	Avanc
08.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	36,000 €	Avanc
26.11.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	27,600 €	Avanc
08.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	24,000 €	Avanc
04.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	24,000 €	Avanc
30.11.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	19,200 €	Avanc
08.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	15,600 €	Avanc
13.05.2020	Organizimi I kampionatit botëror ne hendboll-2022	15,000 €	Avanc
08.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	14,400 €	Avanc

26.11.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	14,400 €	Avanc
16.09.2020	Memorandum Bashkëpunimi TM1-2020	13,707 €	Avanc
22.05.2020	Memorandum Bashkëpunimi TM2-2019	13,278 €	Avanc
30.11.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	12,000 €	Avanc
18.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	11,000 €	Avanc
04.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	10,800 €	Avanc
18.09.2020	Monografia E Futbollit te Kosovës	9,746 €	Avanc
08.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	9,600 €	Avanc
08.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	9,600 €	Avanc
08.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	8,400 €	Avanc
29.10.2020	Mbështetje Financiare -2020	8,125 €	Avanc
25.03.2020	Klubi skitar Prishtina ne Bullgari	7,600 €	Avanc
15.04.2020	Mbulimi I shpenzimeve për stafin e shtëpisë se sportit	6,995 €	Avanc
10.07.2020	Subvencion	6,695 €	Avanc
20.03.2020	Gara ndërkombëtare Kupa e Gjericës	6,250 €	Avanc
08.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	6,000 €	Avanc
02.07.2020	Subvencion-2020	6,000 €	Avanc
27.04.2020	Avancimi I programeve ne sport -2020	5,000 €	Avanc
19.08.2020	Organizimi I turneut Amerika dhe Diaspora	5,000 €	Avanc
14.07.2020	Turneu tradicional Burim Hatipi	4,900 €	Avanc
08.12.2020	Memorandum bashkëpunimi, Ligji për rimëkëmbje Ekonomike/2020	4,800 €	Avanc
08.12.2020	Memorandum bashkëpunimi TM2-2020	4,530 €	Avanc
29.10.2020	Mbështetje Financiare	3,500 €	Avanc
19.07.2020	Subvencione ne projekt	2,150 €	Avanc
08.12.2020	Përkrahje financiare -2020	1,550 €	Avanc
Total:		1,235,975 €	

Në tabelën 7 ne kolonën “Kategorizimi i sporteve (pikët)” kemi paraqitur se si janë vlerësuar organizatat sportive me sistemin e pikëve të cilën e kanë fituar nga aktivitetet e vitit paraprak. Ndërsa në kolonën “Shuma e financuar 2020” kemi paraqitur se sa janë financuar organizatat sportive në realitet. Ndërsa në kolonën “Shuma të cilën kanë merituar në bazë të pikëve” kemi paraqitur se sa do duhej përfitonin organizatat sportive në bazë të pikëve të përfituara. Kolona e fundit paraqet diferencën mes shumës së përfituar dhe asaj të merituar.

Tabela 8: Kategorizimi i federatave për vitin 2020.

KATEGORIA A 2020	Kategorizimi i sporteve (pikët)	Shuma e financuar 2020	Shuma e cila ka merituar në bazë të pikëve	Diferenca +,-
Federata e Xhudos e Kosovës	86.40 pikë	144,000 €	172,800 €	-28,800 €
Federata e Futbollit të Kosovës	79.28 pikë	645,281 €	269,552	375,729 €
Federata e Karatesë e Kosovës	78.46 pikë	141,060 €	156,920	-15,860 €
Federata e Hendbollit të Kosovës	76.05 pikë	73,485 €	258,570 €	-185,085 €
Federata e Volejbollit të Kosovës	74.59 pikë	336,680 €	253,470 €	83,210 €
Federata e Basketbollit të Kosovës	74.55 pikë	395,781 €	253,462 €	142,319 €
KATEGORIA B				
Federata e Mundjes të Kosovës	66.01 pikë	79,399 €	106,064 €	-26,665 €
Federata e Boksit të Kosovës	66.54 pikë	58,385 €	106,464 €	-48,079 €
Federata e Atletikës e Kosovës	64.28 pikë	133,898 €	102,840 €	31,058 €
Federata e Sportit Shkollor të Kosovës	58.55 pikë	123,280 €	93,680 €	29,600 €
Federata e PingPongut të Kosovës	58.10 pikë	106,696 €	92,960 €	13,736 €
Federata e Notit të Kosovës	57.99 pikë	68,830 €	92,784 €	-23,954 €
Federata e Tenis të Kosovës	50.00 pikë	70,333 €	80,000 €	-9,667 €
KATEGORIA C				
Federata e Gjymnastikës së Kosovës	47.72 pikë	39,423 €	57,264 €	-17,841 €
Federata e Skitarisë të Kosovës	46.19 pikë	112,890 €	54,428 €	58,462 €
Federata e Taekwondos të Kosovës	45.69 pikë	35,385 €	54,828 €	-19,443 €
Federata e Shahut e Kosovës	41.65 pikë	73,485 €	49,980 €	23,505 €
Federata e Badmintonit e Kosovës	41.63 pikë	32,039 €	49,956 €	-17,917 €
Federata e Triatlonit e Kosovës	41.26 pikë	31,956 €	49,512 €	-17,556 €
Federata e Ragbit e Kosovës	40.64 pikë	16,992 €	48,768 €	-31,776 €
Federata e Shigjetarisë të Kosovës	40.41 pikë	37,581 €	48,492 €	-10,911 €
Federata Shenjëtarisë Sportive	41.58 pikë	35,748 €	49,896 €	-14,148 €
Federata e Çiklizmit të Kosovës	40.10 pikë	68,530 €	48,120 €	20,410 €
Federata e Sportit Universitar	39.04 pikë	57,136 €	46,848 €	10,288 €
Federata e Bodybuildingut e Kosovës	38.91 pikë	45,819 €	46,692 €	-873 €
Federata e Peshëngritjes e Kosovës	35.96 pikë	21,699 €	43,152 €	-21,453 €

Federata e Bowlingut e Kosovës	35.42 pikë	42,938 €	42,504 €	434 €
Federata e Autosporteve e Kosovës	34.79 pikë	54,927 €	41,748 €	13,179 €
Federata Aeronautike e Kosovës	31.27 pikë	29,463 €	37,524 €	-8,061 €
KATEGORIA D				
Federata e Kickboxit e Kosovës	28.23 pikë	23,292 €	22,584 €	708 €
Federata e Muaythait e Kosovës	25.28 pikë	22,312 €	20,224 €	2,088 €
Federata e Bilardos e Kosovës	22.65 pikë	15,530 €	20,000 €	- 4,470 €
Federata Sportive e Punëtorëve	20.70 pikë	14,316 €	16,560 €	- 2,244 €
Federata Minigolfit të Kosovës	18.88 pikë	15,876 €	15,104 €	772 €

Tabela 9: paraqet avancet e hapura të organizatave sportive të cilat kanë përfituar në vitin 2021.

Data	Përshkrimi	Shuma e subvencionimit	Raportimi
16.12.2021	Aneks Memorandum Lojërat Olimpike në Beijing 2022 Strategjia 2021-2024	56,815 €	Avanc
11.12.2021	Memorandum bashkëpunimi TM3, 2021	39,460 €	Avanc
30.12.2021	Aneks Memorandum, Dhjetor 2021 Fillimi i vitit 2022	38,025 €	Avanc
27.12.2021	Aneks Memorandum, Përgatitje për Olimpiadë	10,000 €	Avanc
03.03.2021	Java Evropiane -2020, Be Active	8,100 €	Avanc
30.12.2021	Aneks Memorandum, Dhjetor 2021 Fillimi I vitit 2022	6,958 €	Avanc
30.12.2021	Aneks Memorandum, Dhjetor 2021 Fillimi I vitit 2022	6,254 €	Avanc
04.06.2021	Memorandum bashkëpunimi TM1-TM2-2021	5,663 €	Avanc
10.02.2021	Mbështetje Financiare-2020	5,100 €	Avanc
22.03.2021	Mbështetje Financiare-2020	5,000 €	Avanc
21.05.2021	Mbështetje financiare/2021 Turneu olimpik zizi	5,000 €	Avanc
27.12.2021	Fondi I Ringjalljes, Ekspedita Alpine Mont Blanc France	4,313 €	Avanc

30.12.2021	Fondi I Ringjalljes, Ad hoc	2,700 €	Avanc
21.10.2021	Përkrahje Financiare Pjesëmarrje në aktivitetin Face of America	1,930 €	Avanc
Total:		195,318 €	

Tabela 10 paraqet kategorizimin e organizatave sportive për vitin 2021.

KATEGORIA A 2021	Kategorizimi i sporteve (pikët)	Shuma totale e financuar 2021	Shuma e cila ka merituar në bazë të pikëve	Diferenca +,-
Federata e Xhudos e Kosovës	86.40 pikë	179,600 €	103,680 €	75,920 €
Federata e Futbollit të Kosovës	79.28 pikë	186,128 €	158,560 €	27,568 €
Federata e Karatesë e Kosovës	78.46 pikë	156,920 €	94,152 €	62,768 €
Federata e Hendbollit të Kosovës	76.05 pikë	254,768 €	152,100 €	102,668 €
Federata e Volejbollit të Kosovës	74.59 pikë	295,137 €	149,180 €	145,957 €
Federata e Basketbollit të Kosovës	74.55 pikë	249,741 €	149,100 €	100,641 €
KATEGORIA B				
Federata e Mundjes të Kosovës	66.01 pikë	110,777 €	59,409 €	51,368 €
Federata e Boksit të Kosovës	66.54 pikë	84,807 €	59,886 €	24,921 €
Federata e Atletikës e Kosovës	64.28 pikë	72,315 €	57,852 €	14,463 €
Federata e Sportit Shkollor të Kosovës	58.55 pikë	470,096 €	52,695 €	417,401 €
Federata e PingPongut të Kosovës	58.10 pikë	88,601 €	52,290 €	36,311 €
Federata e Notit të Kosovës	57.99 pikë	26,096 €	52,191 €	-26,095 €
Federata e Tenis të Kosovës	50.00 pikë	76,250 €	45,000 €	31,250 €
KATEGORIA C				
Federata e Gjymnastikës së Kosovës	47.72 pikë	33,404 €	38,176 €	-4,772 €
Federata e Skitarisë të Kosovës	46.19 pikë	69,797 €	36,952 €	32,845 €
Federata e Taekwondos të Kosovës	45.69 pikë	18,276 €	36,552 €	-18,276 €
Federata e Shahut e Kosovës	41.65 pikë	54,145 €	33,320 €	20,825 €
Federata e Badmintonit e Kosovës	41.63 pikë	63,049 €	33,304 €	29,745 €
Federata e Triatlonit e Kosovës	41.26 pikë	41,260 €	33,008 €	8,252 €
Federata e Ragbit e Kosovës	40.64 pikë	40,896 €	32,512 €	8,384 €
Federata e Shigjetarisë të Kosovës	40.41 pikë	16,164 €	32,328 €	-16,164 €
Federata Shenjëtarisë Sportive	41.58 pikë	29,106 €	33,264 €	-4,158 €
Federata e Çiklizmit të Kosovës	40.10 pikë	44,110 €	32,080 €	12,030 €
Federata e Sportit Universitar	39.04 pikë	139,040 €	31,232 €	107,808 €
Federata e Bodybuildingut e Kosovës	38.91 pikë	50,583 €	31,128 €	19,455 €
Federata e Peshëngritjes e Kosovës	35.96 pikë	14,384 €	28,768 €	-14,384 €

Federata e Boëlingut e Kosovës	35.42 pikë	46,046 €	28,336 €	17,710 €
Federata e Autosporteve e Kosovës	34.79 pikë	55,664 €	27,832 €	27,832 €
Federata Aeronautike e Kosovës	31.27 pikë	40,651 €	25,016 €	15,635 €
KATEGORIA D				
Federata e Kickboxit e Kosovës	28.23 pikë	23,290 €	14,115 €	9,175 €
Federata e Muaythait e Kosovës	25.28 pikë	17,696 €	12,640 €	5,056 €
Federata e Bilardos e Kosovës	22.65 pikë	5,663 €	11,325 €	-5,662 €
Federata Sportive e Punëtorëve	20.70 pikë	12,938 €	10,350 €	2,588 €
Federata Minigolfit të Kosovës	18.88 pikë	8,486 €	9,440 €	-954 €

Tabela 11: Kategorizimi i federatave për vitin 2022.

KATEGORIA A 2022	Kategorizimi i sporteve (pikët)	Shuma e financuar 2022	Shuma e cila ka merituar në bazë të pikëve	Diferenca +,-
Federata e Xhudos e Kosovës	83.35	269,370 €	183,370 €	86,000 €
Federata e Futbollit e Kosovës	76.61	39,640 €	0	39,640 €
Federata e Karatesë e Kosovës	78.501	167,542 €	172,702 €	-5,160 €
Federata e Hendbollit të Kosovës	78.093	341,264€	171,804 €	169,460 €
Federata e Volejbollit të Kosovës	79.56	214,532 €	175,032 €	39,500 €
Federata e Basketbollit të Kosovës	78.05	505,090 €	171,710 €	333,380 €
KATEGORIA B				
Federata e Mundjes të Kosovës	65.14	104,890 €	97,710 €	7,180 €
Federata e Boksit të Kosovës	65.16	62,352 €	97,720 €	-35,368 €
Federata e Atletikës e Kosovës	62.6117	50,573 €	93,917 €	-43,344 €
Federata e Sportit Shkollor të Kosovës	64.5	23,551 €	96,750 €	-73,199 €
Federata e PingPongut të Kosovës	60.33	90,495 €	90,495 €	0 €
Federata e Notit të Kosovës	54.68	13,047 €	52,191 €	-39,144 €
Federata e Tenis të Kosovës	51.42	38,565 €	154,260 €	-115,695 €
Federata e Gjimmastikës së Kosovës	53.03	19,886 €	79,545 €	-59,659 €
Federata e Skitarisë të Kosovës	60.75	50,171 €	91,125 €	-40,954 €
Federata e Shahut e Kosovës	51.16	48,270 €	76,740 €	-28,470 €
KATEGORIA C				
Federata e Taekwondo-së të Kosovës	40.28	0	0	0
Federata e Kajakimit te Kosoves	38.76	35,056 €	47,200 €	-12,144 €
Federata e Badmintonit e Kosovës	44.82	27,613 €	53,784 €	-26,171 €
Federata e Triatlonit e Kosovës	47.0443	55,494 €	56,453 €	-959 €

Federata e Ragbit e Kosovës	42.29	25,374 €	50,748 €	-25,374 €
Federata e Shigjetarisë të Kosovës	39.82	23,281 €	47,784 €	-24,503 €
Federata Shenjëtarisë Sportive	46.88	30,203 €	56,256 €	-26,053 €
Federata e Çiklizmit të Kosovës	44.4	34,722 €	53,280 €	-18,558 €
Federata e Sportit Universitar	49.64	156,964 €	59,568 €	97,396 €
Federata e Bodybuildingut e Kosovës	39.42	38,423 €	38,423 €	0
Federata e Peshëngritjes e Kosovës	32.5	12,722 €	39,000 €	-26,278 €
Federata e Bowlingut e Kosovës	32.54	17,413 €	39,048 €	-21,635 €
Federata e Autosporteve e Kosovës	45.55	30,215 €	54,660 €	-24,445 €
Federata Aeronautike e Kosovës	32.16	32,858 €	38,592 €	-5,734 €
Federata e Golfit e Kosovës	34.97	10,491 €	41,964 €	-31,473 €
Federata e Kickboxit e Kosovës	30.27	35,821 €	36,324 €	-503 €
KATEGORIA D				
Federata e Motoçiklizmit të Kosovës	28.28	0	0	0
Federata e Muaythait e Kosovës	27.23	13,615 €	27,230 €	-13,615 €
Federata e Bilardos e Kosovës	24.02	8,900 €	35,600 €	-26,700 €
Federata Sportive e Punëtorëve	28.41	14,205 €	28,410 €	-14,205 €
Federata Minigolfit të Kosovës	17.78	0	0	0

Shtojca III Letër konfirmimi dhe komentet e entitetit



REFERENCË:		21/ SHKURT 2024			
PËR/ZA/TO:		Ariana Gjonbalaj – Shala, Drejtor i Departamentit te Auditimit ne Zyrën Kombëtare te Auditimit			
NGA/OD/FROM:		Ilir Murtezaj, Drejtori Përgjithshëm ne ATK-së			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Letër konfirmim - Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit nga ZKA, në Raportin e auditimit „Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”			
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. kancelarije:	405	Kucni:	038/ 200 25001	Datum:	21.02.2024
Room No.:		Extension:		Date:	

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”** (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Ilir Murtezaj



u.d .Drejtor i Përgjithshëm Administrata Tatimore e Kosovës

Data: 21.Shkurt 2024



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sports

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 08/03/2024

I nderuar,


Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”** (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem pjesërisht me të gjeturat dhe rekomandimet dhe kam dërguar komentet për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Hajrulla Çeku



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Auditimi i kryer: “Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”

Dokumenti: Komentet nga institucioni i audituar në draft raportin e auditimit

Te gjeturat	Pajtoh em po/ jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne raste te mospajtimi	Pikëpamja e ZKA-së
3.1.1 Strategjia për zhvillimin e sportit ende e pa aprovuar	Pjesëri sht	<p>Përkundër mungesës së një dokumenti të veçantë strategjik për sportin, MKRS vazhdimisht ka pasur qasje strategjike për zhvillimin e politikave sportive në vend nëpërmjet katër dokumenteve strategjike shtetërore të miratuara nga Qeveria e Kosovës siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Plani Strategjik Operacional ● Plani Kombëtar për Zhvillim ● Korniza Afatmesme e Shpenzimeve ● Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim <p>Krahas kësaj, dokumenti "Strategjia e Sportit" i cili parasheh periudhën e zhvillimit të politikave sportive deri në vitin 2030, tashmë është në fazën finale pasi që është në proces të lektorimit dhe brenda muajit mars</p>	Përkundër dokumenteve të cilat janë ofruar, MKRS ende nuk ka strategji të aprovuar dhe si pasoj të gjitha aktivitetet e financuara nga MKRS behën pa ndonjë strategji apo program se në cilin drejtim do të zhvillohet sporti në vend. Prandaj e gjetura qëndron dhe komenti i MKRS nuk e ndryshon gjetjen.

		<p>nisin konsultimet publike. Për hartimin e këtij dokumenti MKRS ka formuar grupin e parë punues në vitin 2022, ndërsa siç është përmendur edhe në raport, me qershor 2023 drafti i strategjisë është prezantuar në Tryezën e Tretë të Sportit. Procesi i miratimit të strategjisë është zgjatur pasi që në po në vitin 2023 Kosova e fitoi të drejtën e organizimit të "Lojërave Mesdhetare 2030", me ç'rast është vlerësuar e domosdoshme që ky organizim madhor të reflektohet edhe në dokumentin "Strategjia e Sportit".</p>	
<p>3.1.2 Përdorimi i sponsorizimit për fushatë marketingu të kompanive private</p>	<p>Pjesëri sht</p>	<p>3.1.2 Përdorimi i sponsorizimit për fushatë marketingu të kompanive private</p> <p>Pas analizimit të Draft Raportit të Auditimit, komisioni e ka shqyrtuar dhe analizuar komentin dhe do të ketë kujdes që gjatë shqyrtimit të kërkesave dhe mbylljes së raporteve të mos pranohen shpenzimet që do të promovojnë bizneset, logot dhe produktet e tyre me qëllim të shfrytëzimit të zbritjeve të lejuara për sponsorizime.</p> <p>Për rastin specifik që keni analizuar, pranimi i shpenzimeve për LED-a (si marketing) është pranuar për arsye të predispozitave të rregullorës së garave të FBK-së, ju informojmë se reklamimi nuk është vetëm marketing i sponsorëve por është fushatë me interes publik si: lufta kundër abuzimit të fëmijëve, fushata kundër kancerit të gjirit, kundër diskriminimit etj. Prova:</p>	<p>E gjetura qëndron dhe komenti i MKRS nuk e ndryshon gjetjen.</p> <p>Ligji nr. 05/1-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, e specifikon shumë qartë: Sponsorizimi – mbështetje financiare dhe materiale në bazë të vullnetit të lirë që jepet nga personat fizik apo juridik të vendit dhe të huaj me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.</p> <p>Gjatë auditimit kemi hasur në raste kur janë kryer blerje të cilat nuk hyjnë në kategorinë e aktiviteteve sportive për të cilat i kemi dëshmuar në raport.</p>

		<p>Doracakun e Federatës së Basketbollit të Kosovës për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese në LED.</p> <p>Megjithatë, ju informojmë se për shkak të zbrastësirave ligjore dhe mangësive të ligjit aktual të Sponsorizimit i cili shkakton vështirësi në zbatimin e kësaj politike të financimit të sportit në vend, në Planin Legjislativ për vitin 2024 është planifikuar Plotësim Ndryshimi i Ligjit për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Rregulloren (MKRS) nr.01/2018 për Përcaktimin e Kritereve, Procedurave dhe Formës për Vërtetimin e Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.</p>	
3.1.5 Konfliktet e mundshme të interesit në procesin e vlerësimit të sponsorizimit	Pjesëri sht	<p>Komisioni për shqyrtimin e kërkesave është themeluar në bazë të Rregullores (MKRS) nr. 01/2018 për Përcaktimin e Kritereve, Procedurave dhe Formës për Vërtetimin e Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Pra, deri tash MKRS ka zbatuar ligjin aktual të sponsorizimit.</p> <p>Pajtohemi se duhet të rregullohet kjo çështje, andaj edhe me ndryshimin e legjislacionit do të inkorporohet rekomandimi i institucionit tuaj.</p>	E gjetura qëndron, po ashtu MKRS është pajtuar së do të marr veprime për rregullimin e kësaj çështje
3.1.6 Mos raportimi me kohë nga	Pjesëri sht	MKRS ka zbatuar Nenin 12, pikën 6 të Rregullores (MKRS) nr.01/2018 për Përcaktimin e Kritereve, Procedurave dhe Formës për Vërtetimin e	E gjetura qëndron. MKRS nuk ka mbajtur përgjegjës të gjithë përfituesit e sponsorizimit me qëllim të raportimit me kohë dhe të

organizatat sportive		<p>Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në rast se një përfitues i sponsorizimit nuk e përmbush detyrën e tij për raportim vjetor lidhur me sponsorizimin e realizuar, nuk do t'i mundësohet trajtimi i lëndëve tjera.</p> <p>Komisioni nuk ka trajtuar kërkesat për organizatat sportive të cilat nuk kanë raportuar për mbyllje, si dhe për organizatat sportive të cilat nuk janë licencuar pranë MKRS-së. Ju informojmë se trendi i raportimeve dhe mbylljes ka pëmirësim të theksuar. Raportimet nuk mund të bëhen për vitin fiskal pasi që kontratat i referohen periudhave sezonale të sportit .</p>	<p>sakte të shpenzimit të fondeve të sponsorizimit.</p> <p>Po ashtu për rastet e mos raportimit, MKRS nuk ka ndërmarrë masa ndaj tyre.</p>
3.2.1 Vonesa në caktimin e koeficientit për federata	Pjesërisht	<p>Vonesa në caktimin e koeficientit për federatat sportive është shkaktuar për arsye të afateve kohore të përcaktuara në Rregulloren (MKRS) Nr. 04/2018 për Kategorizimin e Sporteve, siç edhe është përmendur në raport. Këtë problematikë MKRS e ka pasur të identifikuar qysh më herët dhe si pasojë ka reflektuar me miratimin e Rregullosës së re (MKRS) nr. 13/2022 për Kategorizimin e Sporteve, i cili ka hyrë në fuqi në muajin dhjetor të vitit 2022 dhe kriteret e saj janë zbatuar për herë të parë në vlerësimin e pikëve të kategorizimit në vitin 2024.</p> <p>Si rrjedhojë është arritur një progres i madh në caktimin e hershëm të koeficientit të kategorizimit dhe si rrjedhojë</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Nga komenti shihet se MKRS e pranon këtë gjetje dhe sipas tyre ata janë zotuar që të ndërmarrin masa për rregullimin e kësaj problematike.</p>

	<p>nënshkrimit me kohë të Memorandumeve me federatat. Ky progres ka mundësuar që memorandumet të nënshkruhen 3 muaj më herët, pasi që në vitin 2021 ato janë nënshkruar në muajin maj, ndërsa në vitin 2024 me anë të rregullores së re janë nënshkruar në muajin shkurt.</p> <p>Për më shumë, rregullorja e re e parasheh vlerësimin e pikëve të kategorizimit nga ana e komisionit të formuar nga MKRS, ndryshe nga më herët që është bërë nga Komiteti Olimpik i Kosovës i cili përbëhet nga anëtarët e federatave sportive, duke shmangur kështu edhe rrezikun e konfliktit të interesit.</p> <p>Një tjetër faktor për vonesat në financimin e federatave sportive është edhe për shkak të rregullave përkatëse të federatave sportive vendore dhe atyre ndërkombëtare, pasi që federatat sportive ndjekin procesin e organizime të Kuvendeve të tyre të Punës në përputhje me rregullat e federatave përkatëse ndërkombëtare, ku në shumicën e rasteve Kuvendet zhvillohen në periudhën shkurt dhe mars. Nga vendimet e marra në këto Kuvende më pas reflektohen në Planin e Aktiviteteve Vjetore të federatave dhe planifikimin buxhetor të tyre. Këto dokumente federatat obligohen t'i dorëzojnë në MKRS në përputhje me buxhetin e paraparë nga Memorandumi i nënshkruar nëpërmjet kategorizimit.</p>	
--	--	--

<p>3.2.2 Financimi i përfaqësu eseve të federatave sportive është përcjellur me mangësi</p>	<p>JO</p>	<p>Në lidhje me pikën 3.2.2 të raportit, nuk qëndon pretendimi se “Federatat sportive në Kosovë nga viti 2020 deri me 25 tetor 2022 nuk kanë qenë të licencuara”, pasi që Ministri ka marrë vendim për vazhdim të vlefshmërisë së licencave të federatave sportive është bazuar në zgjatjen e ciklit olimpiq nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) prej 2020 në 2021, për shkak të situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia COVID-19.</p> <p>Sic specifikohet kalimthi edhe në draft raportin tuaj, për shkak të fuqisë madhore dhe gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar nga Covid 19, ashtu sikur edhe të gjitha fushëveprimtaritë e tjera, edhe sektori i sportit është përballur me sfida të shumta. Aq më tepër, situata e jashtëzakonshme e krijuar nga Covid 19 në nivel global, ka shkaktuar edhe shtyerjen e organizimit të Lojërave Olimpikë nga viti 2020, në vitin 2021. Kjo është hera e dytë në historinë e Lojërave Olimpikë, që shkaktohet shtyerje e organizimit, pas herës së parë të vitit 1940 - për shkak të situatës së luftës së asaj kohe.</p> <p>Bazuar në LIGJI I SPORTIT NR. 2003/24, Neni 32, paragrafi 32.1. <i>“Për një degë të caktuar sportive, për tërë territorin e Kosovës, themelohet dhe vepron një federatë e vetme e licencuar”,</i> Federatat sportive shtetërore janë organizata jo-qeveritare të cilat kanë për mandat zhvillimin e sportit brenda territorit të Republikës së</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Sa i përket financimit të federatave me licencë të skaduar, MKRS, nga neglizhenca, nuk i ka paraprirë proceseve që në vitin 2020 për të filluar me licencimin e federatave sportive. Si pasojë, MKRS ka financuar jashtëligjshëm federatat sportive të pa licencuara.</p>
---	-----------	--	--

	<p>Kosovës, si dhe përfaqësimin e shtetit në strukturat ndërkombëtare të sportit përkatës.</p> <p>Referuar në periudhën kohore që merr për bazë ky raport i auditimit të performacës, si dhe pretendimeve të raportit në pikën 3.2.2, për financimin e federatave sportive me licencë të skaduar, në fillim të vitit 2021, numri më i madh i federatave sportive ishin me licencë të skaduar.</p> <p>Konsideruar situatën e krijuar në vitin 2021 nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Gjendja e jashtëzakonshme e Covid 19 në vitin 2021, ● Zgjatja e vitit Olimpik nga 2016-2020 - në 2016-2021, ● Lista finale e kategorizimit të Komitetit Olimpik të Kosovës “ ku rekomandohet që për vitin 2020 mos të bëhet vlerësimi i aktiviteteve sportive për shkak të pandemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19, dhe të vlejë kategorizimi i vitit paraprak (2019) numër të protokolit 354/2021, të datës 30.04.2021 ”, ● Licencat e skaduara të federatave sportive; si dhe <p>zbrastinë ligjore për të adresuar një situatë të tillë, është krijuar një ngërrq ligjor për financim të federatave sportive. Në anën tjetër, bazuar në LIGJIN NR. 2003/24, Neni 10 dhe 11, në LIGJI Nr. 04/L-075 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/24 PËR SPORT, Neni 3,</p>	
--	--	--

	<p>sporti është fushë me interes publik shtetëror.</p> <p>Andaj, për të menjanuar dëmin e përgjithshëm me interes publik për zhvillim të sportit dhe për përfaqësim dinjitoz të shtetit në Lojërat Olimpike Tokyo 2021, detyrimisht dhe me të drejta dhe kompetenca që ministri ka në përputhje me RREGULLORE (QRK) - NR. 02/2021 PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT DHE MINISTRIVE, përkatësisht nenit 8, pika 1.4 citohet: Nxjerr vendime, akte nënligjore dhe lidhë marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë; dhe pikës 2.1. Të hartojë dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave të ministrisë; ministri me datën 30/04/2021 merr vendim për vazhdimin e vlefshmërisë së licencave të federatave sportive, me numër të protokollit 1334/2021.</p> <p>Konsideruar zbrastinë ligjore që UDHËZIM ADMINISTRATIV (MKRS) NR. 02/2015 PËR REGJISTRIMIN DHE LICENCIMIN E FEDRATAVE DHE SHOQËRIVE SPORTIVE, kishte, duke mos ofruar mundësi të operimit, si dhe duke mos ofruar kushte dhe kritere të qarta rreth procesit të licencimit të Federatave sportive, MKRS menjëherë ka inicuar procedurat e</p>	
--	---	--

	<p>plotësim/ndryshimit të UA për licencim të federatave sportive.</p> <p>Në përputhje me vendimet e ministrit për vazhdimin e licencave si dhe gjatë vlefshmërisë së vendimit të ministrit, me datën 01/06/2022 hyn në fuqi UDHËZIM ADMINISTRATIV (MKRS) NR. 01/2022 PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E THEMELIMIT, LICENCIMIT DHE RIVLERËSIMIT TË FEDERATAVE DHE ORGANIZATAVE SPORTIVE.</p> <p>Në përputhje me UA NR. 01/2022, MKRS hap procesin e licencimit të Federatave Sportive në vend. Aktualisht në MKRS, janë të licencuara 36 federatat sportive - lista e bashkangjitur. Citojmë: <i>“Licencimi sipas standardeve do të mundësonte financimin vetëm të federatave të cilat plotësojnë kriteret dhe zhvillojnë aktivitetin sportiv”</i> - ju njoftojmë se në MKRS nuk financon federatat sportive të pa licencuara në MKRS. Pra, pikërisht është procesi i licencimit i cili është zhvilluar në kuadër të MKRS - që ka krijuar standard të ri të qeverisjes dhe financimit të sportit në vend.</p> <p>Ndërkaq, me qëllim të përfaqësimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, si dhe bazuar në kërkesën e Komitetit Olimpik të Kosovës për financim të Federatave sportive për pjesëmarrje në aktivitetet ndërkombëtare të datës</p>	
--	--	--

	<p>02/09/2022, MKRS ka mbështetur Komitetin Olimpik të Kosovës për të përkrahur përkrahur pjesëmarrjen e reprezentacioneve të Kosovës në garat ndërkombëtare jashtë vendit për periudhën kohore shtator-dhjetor 2022.</p> <p>Ky memorandum është nënshkuar sipas LIGJI I SPORTIT NR. 2003/24 dhe LIGJI Nr. 04/L-075 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/24 PËR SPORT:</p> <p>- Neni 14, paragrafi 40.4. <i>“Ministria përkatëse për Sport financon përgatitjen e sportistëve të ekipit kombëtar për pjesëmarrje në gara sportive ndërkombëtare”</i></p> <p>Vlerësimi i kërkesave nga KOK, është bërë nga Komisioni i vecantë në kuadër të MKRS dhe është Lista përfituese e Federatave sportive për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare.</p> <p>Provat e bashkangjitura:</p> <p>- Vendim me numër të protokolit 1334/2021</p> <p>-Vendimi me numër të protokolit 2118/2022</p> <p>- UA për licencimin e federatave 01/2022</p> <p>- Raporti i licencimit të federatave sportive</p> <p>-Kërkesa e KOK për mbështetje të federatave</p>	
--	--	--

		<p>-Vendimi për emërimin e Komisionit vlerësues dhe lista e përfituesve sipas vlerësimit</p> <p>-Memorandumi me KOK dhe lënda përcjellëse</p>	
3.2.3 Financimi i organizatave sportive nuk është i rregulluar qartë	JO	<p>Në lidhje me pikën 3.2.3 referuar mënyrës së financimit të organizatave sportive, ju njoftojmë se financimi i organizatave sportive bëhet në përputhje me LIGJIN E SPORTIT NR. 2003/24, LIGJIN Nr. 04/L-075 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/24 PËR SPORT, aktet nënligjore që burojnë nga këto ligje, si dhe politikat sportive të përcaktuara në dokumentet strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.</p> <p>Sa i përket procesit të kategorizimit, mbështetja e federatave sportive nëpërmjet këtij procesi përgjatë viteve 2020-22 është bërë në përputhje të plotë me Rregulloren nr. 04/2018 për Kategorizimin e Sporteve (e cila tashmë nuk është në fuqi), ndërsa që nga viti 2023 e tutje ky proces bazohet në Rregulloren e re me nr. 13/2022 për Kategorizimin e Sporteve.</p> <p>Sipas Rregullores që ka qenë në fuqi në atë kohë, mbështetja e federatave sportive nga procesi i kategorizimit është bërë në përputhje të plotë me rekomandimin e KOK-ut për vlerësimin e pikëve të fituara nga federatat sportive sipas kritereve të përcaktuara në rregullore, dhe</p>	<p>E gjetura qëndron..</p> <p>Sa i përket financimeve të federatave sportive sipas vlerësimit me pikë, është i rregulluar, ndërsa sa i përket anekseve të memorandumeve, MKRS nuk ka bazë ligjore për mënyrën dhe nuk ka kritere për financime të tilla.</p>

	<p>vlerës së koeficientit të përcaktuar nga Ministri.</p> <p>Në raport të auditimit thuhet se “Gjatë analizimit të mostrave për vitet 2020-2022 kemi vërejtur se organizatat sportive marrin subvencion shumë herë më të lartë se sa kanë merituar në bazë të pikëve të bazuara në rregullore për kategorizimin e federatave sportive”. Ky konkludim nga ana e auditorit nuk qëndron sepse subvencionimi i federatave sportive nënkupton jo domosdoshmërisht financim vetëm me anë të procesit të kategorizimit, andaj edhe qëndron diferencimi sipas raportit për shkak se nuk janë konsideruar edhe format e tjera të financimit.</p> <p>Shuma e mbështetjes nga kategorizimi nënkupton shumën e cila i shërben federatës për operim të aktivitetit të saj të rregullt vjetor që përfshinë: organizimin e kampionateve shtetërore në Kosovë, përfaqësimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, shpenzime logjistike dhe administrative etj. Kjo shumë nga kategorizimi zakonisht është në shpërputhje me planin vjetor të federatave të cilat kanë nevojë për buxhet shumë më të lartë dhe është e pamjaftueshme për zbatimin e programeve të tjera që janë me interes të veçantë publik.</p> <p>Mbështetja për financim shtesë të federatave krahas procesit të kategorizimit bazohet në LIGJIN</p>	
--	--	--

	<p>Nr. 04/L-075 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/24 PËR SPORT, përmes këtyre neneve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nenin 10, paragrafin 24.2: <i>“Aktivitetet e Komitetit Olimpik të Kosovës, përkrahen financiarisht nga Ministria përkatëse për Sport dhe nga burimet tjera të parapara me këtë ligj”</i> - Nenin 14, paragrafi 40.4: <i>“Ministria përkatëse për Sport financon përgatitjen e sportistëve të ekipit kombëtar për pjesëmarrje në gara sportive ndërkombëtare”;</i> - Neni 16, paragrafi 51.2: <i>“Ministritë përkatëse për Sport dhe Arsim, me memorandum të përbashkët përcaktojnë mënyrën e themelimit, detyrat, fushëveprimin dhe financimin e organizimit të sportit shkollor si dhe obligohen për zbatimin e tyre”</i> - Nenin 24, paragrafin 65.1: <i>“Bazën e financimit të sportit dhe të nevojave publike e shtetërore, e përbëjnë mjetet financiare që sigurohen nga buxheti i Kosovës”;</i> - Nenin 24, paragrafin 65.3: <i>“Planin e Veprimit për financimin e veprimtarive sportive me interes publik shtetëror, në bazë të propozimit të Ministrisë përkatëse për Sport, e miraton Qeveria e Kosovës”</i> - Nenin 24, paragrafin 65.7: <i>“Ministria përkatëse për Sport në bazë të shkallës së plotësimin të interesit publik ndanë mjetet</i> 	
--	---	--

	<p><i>financiare për Komitetin Olimpik dhe Federatat e Sportit”;</i></p> <p>- si dhe duke u bazuar në Shtyllën e dytë të Planit Kombëtar për Zhvillim “<i>Zhvillimi i Barabartë Njerëzor</i>”, dokument ky i votuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, sektorit numër 7 “<i>Kulturë kreative dhe shoqëri aktive</i>”, qëllimit strategjik 7.3 “<i>Shoqëri aktive dhe e shëndetshme përmes aktivitetit sportiv</i>”, qëllimit strategjik numër 7.5 “<i>Konsolidimi i imazhit shtetëror përmes artit dhe sportit</i>” dhe qëllimit strategjik numër 7.6 “<i>Turizmi sportiv dhe kulturor</i>” përfshihen 16 masa strategjike dhe 51 veprime për zbatimin e masave stragjike në të cilat bazohet puna, planifikimi vjetor dhe financimi i sektorit të sportit nga MKRS.</p> <p>Sipas kësaj, MKRS varësisht nga kërkesat për projekte që i pranon nga federatat sportive dhe interesit publik të saj, buxhetin që ka në dispozicion, si dhe në përputhje me objektivat strategjike të Qeverisë dhe të Ministrisë, përveç mbështetjes nga Kategorizimi ofron edhe mbështetje shtesë për federatat apo organizatat sportive.</p> <p>Prandaj diferencimi i aluduar në raport ndërmjet kategorizimit dhe subvencionimit nuk qëndron, për shkak se nuk është llogaritur forma tjetër e financimit, që parasheh mbështetjen për projekte/programe me interes të veçantë publik.</p>	
--	---	--

	<p>Këto programe/projekte kanë qenë të pamundura të mbështeten nëpërmjet memorandumeve nga kategorizimi edhe për faktin se në kategorizim financimi bëhet me anë të periudhave tremujore (TM), ndërsa në raste të projekteve me interes të veçantë publik ka qenë e domosdoshme transferimi i buxhetit në tërësi me një kësht të vetëm, në mënyrë që më pas të mundësohet zbatimi i projektit në plotëni.</p> <p>Kjo formë e mbështetjes nuk mund të konsiderohet si financim jo i barabartë në krahasim me organizatat e tjera sportive sic aludohet, pasi që financimi është bërë drejtpërsëdrejti tek federatat dhe organizatat sportive të cilat njihen me Ligj të Sportit dhe kanë autonomi të plotë për zhvillimin e sportit përkatës në Republikën e Kosovës duke u njohur nga MKRS me anë të licencimit. Federatat sportive janë organizata jo-qeveritare të cilat me ligj të sportit, janë vetëm një në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ato kanë mandatin për zhvillimin e sportit përkatës brenda territorit shtetëror dhe përfaqësimin e shtetit në arenën ndërkombëtare në organizatat sportive ku ato janë anëtare.</p> <p>Organizatat sportive të mbështetura përmes Aneks memorandumeve sic janë: Xhudo, Basketbolli, Hendbolli, Volejbolli, Shahu, Skitaria, Tenisi, Komiteti Olimpik, Komiteti Paralimpik, Olimpiada Speciale, Federata e Sportit Shkollor, Çiklizmi,</p>	
--	---	--

		<p>Motoçiklizmi, e Futbolli - janë federatat të cilat kanë sjellur kërkesa për mbështetje shtesë nga MKRS për realizimin e planit të tyre vjetor.</p> <p>Për më tej, Neni 24, paragrafi 65.6 i Ligjit Nr. 04/L-075 “Komiteti Olimpik dhe Federatat e Sporteve obligohen që të dorëzojnë planin e aktiviteteve dhe planin vjetor financiar në bazë të kërkesës dhe afatit të caktuar nga Ministria” është baza ligjore mbi të cilën Departamenti i Sportit i pranon kërkesat e federatave sportive për mbështetje financiare shtesë - përtej kategorizimit” për realizimin e planeve të tyre të aktiviteteve të cilat hartohen në përputhje me politikat sportive shtetërore.</p> <p>Provë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji 04/L-075 për plotësim ndryshimin e Ligjit të Sportit - Plani i Veprimit dhe Planifikimi Financiar i Federatës së Basketbollit 2022 - Plani i Veprimit dhe Planifikimi Financiar i Federatës së Hendbollit 2022 <p>Memorandumi me FVK, FTK, FBOXK, FASK - neni 9 AMANDAMENTIMIT</p>	
3.2.4 Avancet e pa mbyllura të federatave	Pjesëri sht	Avancet e pa mbyllura të federatave dhe klubeve sportive kryesisht janë të trashëguara nga viti 2020, nëpërmjet mjeteve buxhetore të ndara për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes	E gjetura qëndron. Është analizuar i gjithë procesi i avancave të MKRS-së, dhe MKRS nuk ka të drejtë të japë financime të tjera pa i mbyllur avancat e kaluara. Nga analiza e listave të

<p>dhe klubeve sportive të cilat kanë përfituar në vitin 2020 - 2022</p>	<p>Ekonomike sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 10/33 të datës 28.09.2020 dhe sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 12/38 të datës 30.10.2020 të aprovuar për Planin e Veprimit të MKRS-së, me të cilin janë përcaktuar kriteret për shpërndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 2.5 milionë euro, ku prej tyre 1.5 milionë janë ndarë për fushën e sportit nëpërmjet nën-programit Sportet e Gjëra.</p> <p>Qëllimi i kësaj pakoje ka qenë zvogëlimi i ndikimit negativ të pandemisë në ekonomi dhe mundësisë së rialokimit të resurseve dhe stimulimit të rritjes së aktivitetit ekonomik. Për shkak se memorandumet e nënshkruara me federatat sportive nga kjo pako janë bazuar te Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi si dhe rregullave të Thesarit (neni 5.4.) dhe jo sipas dispozitave të vendimit të Qeverisë për subvencionim të linjës së pagave, është krijuar kjo zbrazëti që e ka vështirësuar procesin e mbylljes. Si pasojë, shumica e përfituesve nuk kanë raportuar mbylljen.</p> <p>Përveç kësaj, kjo pikë është e ndërlidhur edhe me pikën 3.2.3 për mënyrë e financimit të organizatave sportive, ku nga komentet prej anës tonë është sqaruar që mbështetja për organizatat sportive bëhet në dy forma të ndryshme të financimit:</p>	<p>subvencionimeve shihet se federatat kanë avance prej vitit 2020, 2021 dhe 2022. Pra MKRS duhet të i mbajë përgjegjës përfituesit e fondeve publike që të raportojnë me kohë dhe për mënyrën e shpenzimit të parasë publike.</p>
--	--	--

	<p>1. Financimi përmes procesit të kategorizimit, bazuar në Rregulloren për Kategorizimin e Sporteve</p> <p>2. Financimi për mbështjete për projekte/programe me interes të veçantë publik, bazuar në Ligjin e Sportit</p> <p>Në rastin e parë, përfituesit obligohen që mbylljen ta bëjnë me anë të raportimeve për periudhat tremujore, ndërsa në rastin e dytë, varësisht nga kohëzgjatja e programit raportimi dhe mbyllja bëhet vetëm një herë në fund pasi të përfundojë projekti.</p> <p>Edhe në këtë rast nga raporti i auditorit është bërë klasifikimi i gabuar sepse është konsideruar në tërësi i gjithë financimi si nga ana e kategorizimit, ashtu edhe nga ajo e financimit me anë të projekteve me interes të veçantë publik.</p> <p>Shembull është rasti i avanceve të hapura të Federatës sportive 3 e vitit 2022 (tabela 6), e cila ka nënshkruar Memorandum për projekt me interes të veçantë më 30.11.2022 dhe sipas këtij Memorandumi, Federata obligohet ta bëjë mbylljen në tremujorin e parë të vitit 2023. Si rrjedhojë, në raport të vitit 2022 avanci figuron i hapur megjithëse mbyllja është paraparë të bëhet në vitin 2023.</p> <p>Duke pasur parasysh faktin se këto dy forma të financimit nuk janë të ndërlidhura mes veti dhe</p>	
--	---	--

		<p>se një federatë apo organizatë sportive të njohur me Ligj të Sportit mund të përfitojë në të njëjtën kohë nëpërmjet të dyja formave, edhe mbyllja dhe raportimi bëhet në mënyrë të pavarur me njëra tjetrën.</p> <p>Vlen të theksohet se te financimi i federatave përmes kategorizimit, që nga viti 2021 MKRS ka pasur progres të dukshëm në mbyllje të avanseve të TM-ve.</p> <p>Provë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 10/33 të datës 28.09.2020 - Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 12/38 të datës 30.10.2020 - Progresi i avanseve te federatave sportive - MOU dhe lënda përcjellëse nga Rimekembja FHK dhe FNK 2020 - MOU dhe lënda përcjellëse e FHK, FXHK, FBK dhe FSSHK nga Memorandumi i kategorizimit dhe Memorandumi për projekt/program me interes të veçantë publik 	
3.2.6 Keq menaxhim i projektit data-baza	Pjesëri sht	Sa i përket projektit përfitues në fjalë nga thirrja publike e vitit 2021, në aplikacionin për subvencionim projekti është	E gjetura qëndron. Në dosje, kishte dëshmi se MKRS kishte refuzuar ta mbyllte avancin për këtë

sportive e Kosovës		<p>vlerësuar me pikë të mjaftueshme për të fituar mbështetje dhe më pas procesi ka vazhduar në mënyrë të rregullt nga ana e komisionit vlerësues dhe procedurave të nevojshme të thirrjes publike.</p> <p>Për zbatimin e këtij projekti organizata përfituese ka kërkuar shtyrje të kohëzgjatjes për zbatim dhe si rrjedhojë edhe raporti përmbyllës është dorëzuar me vonesë.</p> <p>Gjatë procesit të auditimit nga ZKA, është mësuar se kjo lëndë nuk është trajtuar fare nga ana e zyrtarëve përgjegjës të MKRS-së për mbyllje të saj që nga data e dorëzimit të raportit, megjithëse të njëjtit obligohen që lëndët t'i trajtojnë dhe në rast të mos përmbyshjes së kriterëve për mbyllje, ta njoftojnë përfituesin për përmirësim të dokumentacionit. Kjo gjetje është adresuar për trajtim të mëtejshëm dhe për vlerësimin e raportit përmbyllës.</p>	<p>projekt për shkak të paqartësive rreth cilësisë së projektit. Për më shumë, edhe në vlerësimin e aplikacionit për subvencionim ishte e nënshkruar vetëm nga njëri anëtarë i komisionit.</p> <p>Duke marrë parasysh që Ministria nuk e ka shfrytëzuar as shqyrtuar raportin final të përfituesit edhe pas afër 9 muajve për të cilin kishte paguar 121,430 euro, tregon për keq menaxhimin e të gjithë procesit lidhur me këtë subvencionim dhe rrjedhimisht mos arritje të vlerës për parane e shpenzuar. Organizata nuk ka kërkuar zgjatjen e afatit për raportim, siç arsyetohet nga MKRS. Komenti i MKRS se gjatë procesit të auditimit të ZKA-së është mësuar se kjo lëndë nuk është trajtuar, paraqet qartë se MKRS nuk ka një sistem për të siguruar cilit për fondet e shpenzuara për aktivitete sportive arrijnë qëllimet për të cilat janë dhënë.</p>
3.2.7 Mungesa e monitorimit të subvencionuara dhe	Pjesëri sht	Në lidhje me pikën 3.2.7 të raportit tuaj, monitorimi i aktiviteteve sportive në terren vazhdon të mbetet sfidë e kahmotshme e MKRS duke konsideruar numrin e madh të aktiviteteve që zhvillohen për	E gjetura qëndron. MKRS nuk ka sistem i cili verifikon apo vërteton se aktivitetet e subvencionuara arrijnë qëllimet e tyre dhe realizohen. Nga mostrat e analizuara përveç që një pjesë e madhe e organizatave sportive nuk raportojnë, ato të cilat raportojnë përgatitin një raport narrativ i cili është

sponsoriz uara:	brenda vendit por edhe jashtë vendit. Përveç monitorimeve të cilat bëhen përmes ndjekjes së aktiviteteve nga afër, si dhe monitorimit përmes mediave dhe platformave elektronike, Departamenti i sportit ka hartuar forma të vecanta të standardizuara të raportimit të mbylljes së projekteve nga organizatat sportive.	shumë i thjeshtë dhe nuk përmbajnë dëshmi shtesë.
--------------------	---	--